



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---


Nr. 10/121  
Datë: 25.01.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 janar 2023, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për Akademinë e Drejtësisë.
2. Obligohet Ministria e Drejtësisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

**MINISTRIA E DREJTËSISË**  
**MINISTARSTVO PRAVDE / MINISTRY OF JUSTICE**

**KONCEPT DOKUMENTI PËR AKADEMINË E DREJTËSISË**

Dhjetor, 2022

Përmbledhje e koncept dokumentit .....	3
Hyrje.....	5
1.1. HYRJE NË PËRKUFIZIMIN E PROBLEMIT .....	6
1.2. ZBATIMI I ACQUIS SË BE-SË DHE STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE.....	8
1.3 Shtetet në rajon .....	16
1.4 Korniza e politikave dhe e legjislacionit të Kosovës .....	21
1.5 Elaborimi i problemit kryesor .....	27
7. Mosekzistim i trajnimeve të specializuara.....	43
Kapitulli 3: Opcionet.....	46
Kapitulli 3.1: Opcioni asnjë ndryshim.....	46
Kapitulli 3.2: Opcioni për përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit politikave dhe legjislacionit ekzistues .....	47
Kapitulli 3.3: Opcioni për ndryshimin dhe plotësimin e kornizës ekzistuese ligjore ..	48
Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme.....	55
Kapitulli 4.1: Sfidat me mbledhjen e të dhënave .....	56
Kapitulli 5: Komunikimi dhe konsultimi .....	57
Kapitulli 6: Krahasimi i opsioneve .....	58
Kapitulli 7: Konkluzionet dhe hapat e ardhshëm .....	62
Kapitulli 7.1: Dispozitat për monitorimin dhe vlerësimin .....	62
Shtojca 1: Forma e vlerësimit për ndikimin ekonomik .....	63
Shtojca 2: Forma e vlerësimit për ndikimet shoqërore .....	66
Shtojca 3: Forma e vlerësimit për ndikimet mjedisore.....	70
Shtojca 4: Forma e vlerësimit për ndikimin e të drejtave themelore .....	73

## Përmbledhje e koncept dokumentit

<b>Informacionet e përgjithshme</b>	
Titulli	Koncept Dokumenti për Akademinë e Drejtësisë
Ministria bartëse	Ministria e Drejtësisë; Departamenti për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave (DIEKP)
Personi kontaktues	Selvije Elezaj-Brahimaj, Udhëheqëse e Divizionit për Koordinim të Politikave, Departamenti për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave (DIEKP), Ministria e Drejtësisë
Plani Strategjik Operacional	Koncept Dokumenti është i paraparë në listën e koncept dokumenteve për vitin 2022
Prioriteti strategjik	Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021-2025. <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përmirësimi i funksionimit të institucioneve të drejtësisë</li> </ul>

<b>Vendimi</b>	
Çështja kryesore	
Përmbledhje e konsultimeve	
Opsioni i propozuar	Opsioni nr. 3 Plotësim ndryshimi i Ligjit për Akademinë e Drejtësisë

<b>Ndikimet kryesore të pritshme</b>	
Ndikimet buxhetore	
Ndikimet ekonomike	
Ndikimet shoqërore	
Ndikimet mjedisore	
Ndikimet ndër-sektorale	

Ngarkesat administrative për kompanitë	
Testi i NVM-ve	Nuk ka ndikime të drejtpërdrejta relevante.

<b>Hapat e ardhshëm</b>	
Afatshkurtër	
Afatmesëm	

## Hyrje1

Figura 1: Tabela me informacione të përgjithshme për koncept dokumentin

Titulli	Koncept Dokumenti për Akademinë e Drejtësisë
Ministria bartëse	Ministria e Drejtësisë, Departamenti për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave (DIEKP)
Personi kontaktues	Selvije Elezaj-Brahimaj, Udhëheqëse e Divizionit për Koordinim të Politikave, Departamenti për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave (DIEKP), Ministria e Drejtësisë
PSO	Koncept Dokumenti është i paraparë në listën e Koncept Dokumenteve të vitit 2022
Prioriteti strategjik Objektiva Operacionale	<ul style="list-style-type: none"><li>• Përmirësimi i funksionimit të institucioneve të drejtësisë</li><li>• Avancimi i legjislacionit për administratën e gjykatave, prokurorive dhe Akademinë e Drejtësisë</li></ul>
Grupi punues	<ol style="list-style-type: none"><li>1. Selvije Elezaj-Brahimaj, Kryesuese,</li><li>2. Ardian Mehmeti, Zëvendës Kryesues,</li><li>3. Eros Gashi, anëtarë</li><li>4. Enver Peci, anëtarë</li><li>5. Enver Fejzullahu, anëtarë</li><li>6. Vaton Derguti, anëtarë</li><li>7. Armend Zenelaj, anëtarë</li><li>8. Vilard Bytyqi, anëtarë</li><li>9. Idain Smajli, anëtarë</li><li>10. Taulant Racaj, anëtarë</li><li>11. Labinot Gashi, anëtarë</li><li>12. Fjolla Sojeva, anëtare</li><li>13. Florentina Beqiraj, anëtare</li><li>14. Saranda Salihu, anëtare</li><li>15. Albert Selimi- anëtarë</li><li>16. Alberita Hyseni-anëtare</li><li>17. Gezim Bislimi- anëtarë</li></ol>

<sup>1</sup> Shprehjet të cilat përdoren në këtë dokument për personat fizik në njërin gjini, nënkuptojnë shprehje të njëjta edhe në gjininë tjetër.

## 1.1. HYRJE NË PËRKUFIZIMIN E PROBLEMIT

### 1.1.1 Sfondi

Sistemi gjyqësor dhe prokurorial i Kosovës ka investuar dhe vazhdon të investojë shumë në ngritjen e kapaciteteve të bartësve të funksioneve gjyqësore dhe prokuroriale dhe personelit të tyre ndihmës pasi që kjo komponentë përbën një ndër hallkat më të ndjeshme në ngritjen e përgjithshme të shkallës së efikasitetit në sistemin gjyqësor dhe prokurorial të Kosovës.

Komponenti i ngritjes së profesionalizmit të gjyqtarëve dhe prokuroreve ka zanafillën e vet që nga paslufta, kur në vitin 2000 u themelua Instituti Gjyqësor i Kosovës (IGJK) me mbështetjen e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), si institucion të cilit iu besua trajnimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve. Në aspektin ligjor, Instituti Gjyqësor themelohet tek në vitin 2003, përmes Udhëzimit Administrativ të UNMIK-ut 2003/31 si organ kompetent për ofrimin e arsimit të vazhdueshëm juridik për gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë.

Që nga ajo kohë, IGJK ka pësuar disa ndryshime në mandatin e saj. Në vitin 2006 nxjerrët Ligji i ri për Institutin Gjyqësor të Kosovës që e (ri) themelon Institutin Gjyqësor me mandat të ri që përfshinë edhe përgjegjësitë e tij për koordinimin e nevojave për i) aftësimin profesional të gjyqtarëve dhe të prokurorëve të Kosovës, dhe ii) për zgjedhjen dhe aftësimin e kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë. Me këtë Ligj, IGJK-ja ka qenë organ i cili ka bërë përzgjedhjen e kandidatëve për gjyqtarë e prokurorë e mandej edhe aftësimin e tyre.

Ky ligj përcaktonte se IGJK-ja zgjedh *“kandidatët për postin e gjyqtarit apo prokurorit zgjedhën në bazë të konkurrimit publik dhe të hapur përmes të cilit ata i nënshtrohen provimit përgatitor për gjyqtarë dhe prokurorë. Personi mund të zgjedhet si kandidat për postin e gjyqtarit apo prokurorit vetëm nëse e kalon provimin përgatitor për gjyqtar dhe prokuror. Përvoja e punës dhe rezultati i provimit të jurisprudencës gjithashtu mund të merren parasysh në zgjedhjen e kandidatëve për postin e gjyqtarit apo të prokurorit.”*

IGJK ishte gjithashtu përgjegjëse për trajnime për stafin e gjykatave dhe prokurorisë sipas nevojës.

Aktualisht, institucioni kryesor i mandatuar për të ofruar trajnime është Akademia e Drejtësisë, e themeluar me Ligjin 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë, e cila kryen funksionet si në vijim:

- harton programet e trajnimit dhe organizon trajnimet për gjyqtarë dhe prokurorë të shtetit në pajtim me legjislacionin në fuqi;
- zhvillon procesin e vlerësimit të nevojave për trajnime përmes mekanizmave të përcaktuar nga Akademia, dhe në bazë të kërkesave të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Këshillit Prokurorial të Kosovës;
- organizon trajnime për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial, pas koordinimit paraprak të nevojave për trajnime me KGJK-në dhe KPK-në, në pajtim me legjislacionin në fuqi;
- mund të organizojë trajnime të vazhdueshme profesionale për avokat shtetëror, avokat, noter, përmbarues privat, ndërmjetësues, administratorët falimentues, si dhe profesione tjera në bazë të vlerësimeve të Akademisë, sipas kërkesave të institucioneve kompetente;
- zhvillon dhe realizon programet e trajnimeve në bashkëpunim me KGJK-në dhe KPK-në, Odat e profesioneve të lira apo institucionet përkatëse;
- mban të dhëna për trajnime dhe programe që realizohen në Akademi në pajtim me legjislacionin në fuqi;
- vendos dhe mban bashkëpunim me institucionet vendore dhe institucionet e huaja të ngjashme lidhur me punët të cilat i kryen, duke përfshirë praktikat profesionale dhe programet e shkëmbimit;
- kryen analiza, hulumtime dhe bashkëpunon me institucionet shkencore;
- kryen veprimtari botuese në përmbushje të mandatit për nevojat e sistemit gjyqësor dhe prokurorial dhe profesioneve të lira;
- kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj dhe me akte tjera të Akademisë.

Me Ligjin për Akademinë e Drejtësisë, si dhe konform pakos së reformave ligjore të gjyqësorit dhe prokurorisë në vitin 2013, Akademia nuk është më përgjegjëse për të organizuar provimin hyrës për kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë, por vetëm për të zhvilluar trajnimin fillestar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, dhe i cili komponentë do të shtjellohet më tutje në këtë koncept dokument.

Për më tepër, me këtë Ligj i'u janë shtuar edhe profesionet e lira ligjore si bartës potencialë që mund të marrin shërbime të trajnimeve nga Akademia, siç janë: avokatët shtetërorë, avokatët, noterët, përmbaruesit privatë, ndërmjetësuesit dhe administratorët falimentues.



### 1.1.2 ÇËSHTJET QË KËRKOJNË DISKUTIM

Aktualisht Akademia e Drejtësisë ka Bordin e saj e cila përbëhet<sup>2</sup> prej përfaqësuesve të sistemit gjyqësor dhe prokurorial si dhe një përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, dhe udhëhiqet nga Drejtori. Akademia e Drejtësisë i raporton Kuvendit.

Gjatë 2021 Akademia e Drejtësisë ka ofruar trajnime të vazhdueshme për gjyqtarë dhe prokurorë, kurse trajnime fillestare ka ofruar për gjyqtarë dhe prokurorë.

Përkundër një buxheti shumë të ulët dhe me burime njerëzore të kufizuara, Akademia suksesshëm ka përballuar kërkesat dhe nevojat e dala nga sistemi gjyqësorë dhe prokurorial.

Megjithatë, disa çështje që kanë rezultuar si diskutabile e që ky Koncept Dokument i adreson, janë edhe deduksion i ndryshimeve të shpeshta që i janë bërë kuadrit normativ që ka rregulluar statusin juridik të Akademisë, çështjet në lidhje me organet udhëheqëse të Akademisë dhe personelin e saj, si dhe parimet për trajnime, përfshirë çështjet në lidhje me trajnimin fillestar, të vazhdueshëm dhe për specializim, si dhe çështjet me trajnuesit dhe mentorët, pra të gjitha do të trajtohen në këtë koncept dokument.

## 1.2. ZBATIMI I ACQUIS SË BE-SË DHE STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE

Përgjatë Procesit të Rishikimit Funkcional të Sektorit të Drejtësisë, pjesa e trajnimeve është diskutuar gjerësisht dhe aty janë elaboarur gjerësisht praktikatat më të mira dhe standardet në lidhje me trajnimet e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Kur diskutohet për trajnimet në gjyqësor, dihet botërisht se nuk ekziston një model i njëjtë i zbatuar në Evropë për trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Ndonëse ekzistojnë standardet minimale të themeluara nga institucione dhe organizata të ndryshme evropiane, fatkeqësisht, Kosova nuk ka qenë e suksesshme të bëhet anëtare e plotë e organizatave të cilat kanë rol vendimtar dhe kritik në vendosjen e nivelit të standardeve, përfshirë fushën e trajnimit siç është Këshilli i Evropës (KKGJE dhe KKPE) dhe RRETGJ.

---

<sup>2</sup> Tre (3) anëtarë të emëruar nga KGJK dhe atë, një (1) gjyqtar nga Gjykata Themelore, një (1) nga Gjykata e Apelit dhe një (1) nga Sekretariati i KGJK-së, 3 (tre) anëtarë të emëruar nga KPK dhe atë, një (1) prokuror nga Prokuroria Themelore, një (1) nga Prokuroria e Apelit dhe një (1) nga Sekretariati i KPK-së dhe një (1) anëtar i emëruar nga Ministria e Drejtësisë.

Dosido, standardet evropiane dhe ndërkombëtare të përcaktuara nga dokumente të shumta zyrtare theksojnë parimin e pavarësisë së Institucionit të Trajnimit Gjyqësor.

Ky Koncept Dokument do t'i diskutojë këto standarde të mishëruara në dokumente të ndryshme dhe do të identifikojë pjesët të cilat akoma mund të adresohen në kuadër të kontekstit të Kosovës.

## **Kombet e Bashkuara**

Në nivel ndërkombëtar, një ndër dokumentet më me rëndësi është Parimet bazë për pavarësinë e gjyqësorit të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së,<sup>3</sup> ku konkretisht neni 10 i këtyre Parimeve cek se “Personat e përzgjedhur për funksione gjyqësore duhet të jenë individë me integritet dhe aftësi **dhe me trajnime** apo kualifikime të duhura në drejtësi.”

## **Këshilli i Evropës**

Ne nivel evropian, rolin më të rëndësishëm për të promovuar pavarësinë e institucioneve trajnuese për bartësit e funksioneve gjyqësore dhe nevojën për trajnime është Këshilli i Evropës.

Këshilli i Evropës, përmes disa instrumenteve kërkon nga shtetet të vendosin dhe ruajnë pavarësinë institucionale të autoriteteve gjyqësore. Kësisoj është edhe **Rekomandimi i Këshillit të Evropës (2010)12**<sup>4</sup>, i cili cek se “**Një autoritet i pavarur** duhet të sigurojë, në përputhje të plotë me autonominë arsimore, që programet e trajnimit fillestar dhe në shërbim të plotësojnë kërkesat e transparencës, kompetencës dhe paanshmërisë në funksionet gjyqësore.”

**Parimi III-1a i Rekomandimit të Këshillit të Evropës R (94) 12 i Komitetit të Ministrave**<sup>5</sup> për Shtetet Anëtare mbi pavarësinë, efikasitetin dhe rolin e gjyqtarit kërkon “[...] të sigurohen kushtet e duhura për t'u mundësuar gjyqtarëve të punojnë me efikasitet dhe, në veçanti,

---

<sup>3</sup>Parimet themelore për pavarësinë e gjyqësorit të miratuara nga rezolutat 40/32 të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së të 29 nëntorit 1985 dhe 40/146 të 13 dhjetorit 1985, <https://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/independencejudiciary.aspx>

<sup>4</sup> CM/Rec (2010)12, i miratuar nga Komiteti i Ministrave më 17 nëntor 2010, pika 57.

<sup>5</sup><https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016804c84e>

*duke rekrutuar një numër të mjaftueshëm gjyqtarësh dhe duke ofruar trajnime të përshtatshme, si trajnimi praktik në gjykata dhe, kur është e mundur, me autoritete dhe organe të tjera, përpara emërimit dhe gjatë karrierës së tyre. Një trajnim i tillë duhet të jetë pa pagesë për gjyqtarin dhe në veçanti duhet të ketë të bëjë me legjislacionin dhe praktikën gjyqësore të kohëve të fundit. Kur është e përshtatshme, trajnimi duhet të përfshijë vizita studimore në autoritetet evropiane dhe të huaja, si dhe në gjykata”*

**Kapitulli VI (Trajnimi) i Rekomandimit të KE-së CM/Rec (2010)12** i miratuar nga Komiteti i Ministrave<sup>6</sup> më 17 nëntor 2010, po ashtu cek se:

56. Gjyqtarët duhet të pajisen me trajnime fillestare teorike dhe praktike dhe të vazhdueshme, të financuara tërësisht nga shteti. Këtu duhet të përfshihen çështjet ekonomike, sociale dhe kulturore që lidhen me ushtrimin e funksioneve gjyqësore. Intensiteti dhe kohëzgjatja e një trajnimi të tillë duhet të përcaktohet në dritën e përvojës së mëparshme profesionale.

57. Një autoritet i pavarur duhet të sigurojë, në përputhje të plotë me autonominë arsimore, që programet e trajnimit fillestar dhe në shërbim të plotësojnë kërkesat e çiltërsisë, kompetencës dhe paanshmërisë në funksionet gjyqësore.

**Karta Evropiane për Statusin e Gjyqtarëve** paraqet një tjetër dokument themelor i cili përcakton disa standarde dhe shërben si bazë për secilën demokraci të re për t’iu përmbajtur kërkesave të saj minimale. Ajo është përpiluar për t’i mbuluar të gjithë komponentët kryesorë të zhvillimit të karrierës siç është rekrutimi, trajnimi, karriera dhe përgjegjësitë e gjyqtarëve, si dhe sistemi disiplinor që i drejton ato.<sup>7</sup>

Karta formulon “*të drejtën e gjyqtarit për trajnim gjatë shërbimit*”, konkretisht ai apo ajo duhet të ketë qasje të rregullt në kurset e trajnimit të organizuara me shpenzime publike, që kanë për qëllim të sigurojnë se gjyqtarët mund t’i ruajnë dhe përmirësojnë shkathtësitë e tyre teknike, sociale dhe kulturore. Shteti duhet të sigurojë që programe të tilla trajnimi të organizohen ashtu që të respektojnë kushtet e përcaktuara në paragrafin 2.3, të cilat kanë të bëjnë me rolin e autoritetit të pavarur të referuar në paragrafin 1.3, në mënyrë që të garantohet përshtatshmëria në përmbajtjen e kurseve të trajnimit dhe në funksionimin e organeve të cilat zbatojnë kurse të tilla, ndaj kriterëve pa paragjykime, kompetencë dhe paanshmëri.<sup>8</sup>

---

<sup>6</sup> [https://search.coe.int/cm/Pages/result\\_details.aspx?ObjectId=09000016805afb78](https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectId=09000016805afb78)

<sup>7</sup> <https://rm.coe.int/16807473ef>

<sup>8</sup> Ibid.

**Opinion 4 i Komisionit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropian<sup>9</sup> (KKGjE)** për trajnimin përbën një tjetër dokument burimor në nivel evropian kur flasim për trajnim fillestar dhe trajnimin gjatë shërbimit për gjyqtarë. Ky dokument shtron bazën për vendet anëtare të KE dhe shtetet që synojnë anëtarësimin për t'iu përmbajtur standardeve minimale të saj me rastin e rregullimit, zbatimit dhe mbrojtjes së këtyre parakushteve lidhur me profesionalizmin e gjyqtarëve, siç është përcaktuar në këtë Opinion:

*“trajnimi është kusht i domosdoshëm që gjyqësori të respektohet dhe ta meritojë respektin. Besimi të cilin qytetarët ia kushtojnë sistemit të gjyqësorit do të fuqizohet në qoftë se gjyqtarët kanë njohuri të thellë dhe të shumëllojshme e cila shtrihet përtej fushës teknike të ligjit në fushat që janë shqetësim i rëndësishëm social, si dhe në gjykatore dhe në shkathtësi personale dhe mirëkuptim që u mundëson atyre t'i menaxhojnë lëndët dhe të përballen me të gjithë personat e përfshirë në mënyrë të përshtatshme dhe të ndjeshme. Thënë shkurt, trajnimi është thelbësor për kryerjen në mënyrë objektive, të paanshme dhe kompetente të funksioneve gjyqësore dhe për t'iu mbrojtur gjyqtarët nga ndikimet jo të drejta.”*

Veç kësaj, ky Opinion thotë se “[n]ë mënyrë që të sigurohet ndarje e duhur e roleve, autoriteti i njëjtë nuk duhet të jetë drejtpërsëdrejti përgjegjës edhe për trajnimin edhe ndëshkimin disiplinor të gjyqtarëve. Prandaj KKGJE-ja rekomandon që, nën autoritetin e gjyqësorit apo një organi tjetër të pavarur, trajnimi duhet t'iu besohet një organi të posaçëm të pavarur me buxhet të vetin, i cili kështu do të jetë në gjendje, në konsultim me gjyqtarët, të hartojë programe trajnimi dhe të sigurojë zbatimin e tyre.” Kosova ka zbatuar me besueshmëri këtë kriter duke themeluar fillimisht IGJK-në, e më vonë AD-në si pasardhëse të tij.

Pika 12 e këtij Opinion fton të gjitha vendet që trajnimin ta bëjnë pjesë përbërëse të legjislacionit që rregullon statusin e gjyqtarëve. Duhet theksuar se Kosova nuk ka një ligj të vetëm të caktuar që rregullon të drejtat, përgjegjësitë dhe obligimet e gjyqtarëve dhe prokurorëve, por në vend të kësaj e rregullon atë përmes dispozitave ligjore të shpërndara në pakon e ligjeve të gjyqësorit.<sup>10</sup> Për më tepër, këto **ligje flasin thjeshtë për trajnimin fillestar të gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinj të emëruar, ndërsa heshtë dhe përmban zero dispozita lidhur me trajnimin gjatë shërbimit.**

Opinion (Pika 14 dhe 15 ) më tutje cek rëndësinë e “[...] pavarësisë dhe përbërjes së autoritetit përgjegjës për trajnimin dhe përmbajtjes së tij. Kjo është rrjedhojë e parimit të

---

<sup>9</sup> Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropianë (CCJE), Opinion nr. 4 (2003) mbi trajnimin fillestar dhe gjatë shërbimit për gjyqtarët

<sup>10</sup> Ligji për Gjykatat, Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës, Ligji për Prokurorin e Shtetit.

*përgjithshëm të pavarësisë së gjyqësorit [si dhe] të ruhet pavarësia e autoritetit përgjegjës për hartimin e plan programeve dhe për të vendosur se çfarë trajnimi duhet të ofrohet.”*

Nga aspekti i statusit juridik të Akademisë së Drejtësisë, Opinioni më tutje cek se

*16. Gjyqësori duhet të luajë një rol të madh në vetoete ose të jetë përgjegjës për organizimin dhe mbikëqyrjen e trajnimeve. Prandaj, dhe në përputhje me rekomandimet e Kartës Evropiane për Statutin e Gjyqtarëve, KKGJE mbron që këto përgjegjësi, në secilin vend, t'i besohen, jo Ministrisë së Drejtësisë ose ndonjë autoriteti tjetër që i përgjigjet legjislativit ose ekzekutivit. , por vetë gjyqësorit ose një organi tjetër të pavarur...*

*17. Për të siguruar ndarjen e duhur të roleve, i njëjti autoritet nuk duhet të jetë drejtpërdrejt përgjegjës si për trajnimin ashtu edhe për disiplinimin e gjyqtarëve. Prandaj, KKGJE rekomandon që, nën autoritetin e gjyqësorit ose organit tjetër të pavarur, trajnimi duhet t'i besohet një institucioni të veçantë autonom me buxhetin e vet, i cili është kështu në gjendje, në konsultim me gjyqtarët, të hartojë programe trajnimi dhe të sigurojë zbatimin e tyre.*

Rekomandime tjera të rëndësishme për kontekstin e Kosovës, ndonëse jo të detyrueshme, kanë të bëjnë me përvijimin në mes emërimit dhe trajnimit. Opinioni (pika 18 dhe 19) përcakton se institucioni përgjegjës për trajnime nuk duhet të jetë drejtpërsëdrejti përgjegjës edhe për emërimin apo ngritjen në detyrë të gjyqtarëve.

*18. Ata që janë përgjegjës për trajnimin nuk duhet të jenë gjithashtu përgjegjës të drejtpërdrejtë për emërimin ose ngritjen në detyrë të gjyqtarëve. Nëse organi (dmth. një komision i shërbimit gjyqësor) i përmendur në Opinionin N°1 të KKGJE-së, paragrafët 73 (3), 37 dhe 45, është kompetent për trajnimin dhe emërimin ose promovimin, duhet të sigurohet një ndarje e qartë ndërmjet degëve të tij përgjegjëse. për këto detyra.*

*19. Për të mbrojtur institucionin nga ndikimi i jashtëm i papërshtatshëm, KKGJE rekomandon që personeli drejtues dhe trajnerët e institucionit duhet të emërohen nga gjyqësori ose organ tjetër i pavarur përgjegjës për organizimin dhe mbikëqyrjen e trajnimeve.”*

Lidhur me trajnimin fillestar, Opinioni i KKGJE-së rekomandon:

28. Duke pasur parasysh shumëllojshmërinë e sistemeve për trajnimin e gjyqtarëve në Evropë, KKGJE-ja rekomandon:

i. që të gjithë të emëruarit në poste gjyqësore duhet të kenë apo të arrijnë, para se të fillojnë detyrën, njohuri gjithëpërfshirëse të së drejtës materiale vendore dhe ndërkombëtare dhe procedurave;

ii. që programet e trajnimit më specifike për ushtrimin e profesionit të gjyqtarit duhet të vendosen nga organi përgjegjës për trajnime, dhe nga vet trajnerët dhe gjyqtarët;

iii. që këto programe teorike dhe praktike nuk duhet të kufizohen në teknika vetëm në fusha të pastra ligjore por duhet gjithashtu të përfshijnë trajnimin për etikë dhe një hyrje në fusha tjera të rëndësishme për aktivitetin gjyqësor, siç është menaxhimi i lëndëve dhe administrimi i gjykatave, teknologjia informative, gjuhët e huaja, shkencat shoqërore dhe zgjidhja alternative e kontesteve (ZAK);

iv. që trajnimi duhet të jetë pluralist në mënyrë që të garantojë dhe fuqizojë gjerësinë e pikëpamjeve të gjyqtarit;

v. që, varësisht nga ekzistimi dhe kohëzgjatja e përvojës paraprake profesionale, trajnimi duhet të jetë me kohëzgjatje të konsiderueshme në mënyrë që të shmanget që ai të jetë thjeshtë çështje formale.

Programi i trajnimit fillestar është ri-dizajnuar në vitin 2016 nga ish IGJK-ja, në bashkëpunim me Këshillat, për të reflektuar ndryshimet e reja në legjislacion, të cilat kërkojnë trajnimin fillestar për gjyqtarët dhe prokurorët e emëruar.<sup>11</sup>

Komponenti tjetër thelbësor në karrierën e gjyqtarëve dhe prokurorëve ka të bëjë me trajnimin gjatë shërbimit.

Aspekt tjetër i rëndësishëm i mbuluar me këtë Opinion ka të bëjë me cilësinë e trajnerëve, ku thotë se *“Është e rëndësishme që trajnimi të zhvillohet nga gjyqtarët dhe nga ekspertët në secilën disiplinë. Trajnerët duhet të zgjidhen në mesin e më të mirëve në profesionin e tyre dhe të përzgjidhen me kujdes nga organi përgjegjës për trajnime, duke marrë parasysh njohurinë e tyre të temës që ligjërohet si dhe shkathtësitë e tyre të mësimdhënies.”* Sidoqoftë, kjo pjesë është paksa kritike në kontekstin e Kosovës dhe ky Koncept Dokument do të diskutojë në më shumë hollësi më vonë për cilësinë e trajnerëve, respektivisht çështjet që kanë lindur si rrjedhojë e entitetit që bën përzgjedhjen e tyre.

Komponenti tjetër thelbësor në karrierën e gjyqtarëve dhe prokurorëve ka të bëjë me trajnimin gjatë shërbimit.

---

<sup>11</sup> Para prezantimit të ndryshimeve në Ligjit për Gjykatat dhe Ligjin për Prokurorin e Shtetit, IGJK-ja ishte përgjegjëse për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtar dhe prokuror, që është pretenduar si jo kushtetuese meqenëse Kushtetuta parashihet që Këshillat kanë prerogativën për rekrutim.

Opiniononi hedh disa rekomandime se, normalisht, trajnimi duhet të bazohet në pjesëmarrjen vullnetare të gjyqtarëve dhe të ketë trajnim të obligueshëm gjatë shërbimit vetëm në raste të veçanta; për shembull (në qoftë se gjyqësori apo organi tjetër përgjegjës vendos ashtu) kur gjyqtari emërohet në një pozitë të re apo një lloj tjetër të punës apo funksionit, apo në rast të ndryshimeve themelore në legjislacion.

Përveç trajnimit të obligueshëm për gjyqtarë, siç u përmend më lartë, Kosova respekton rekomandimet e vendosura aty, ndonëse ka hapësirë për përmirësime.

Opiniononi i KKGJE gjithashtu mbulon një nga segmentet më të cënueshme të trajnimit profesional gjyqësor, më saktësisht vlerësimin e trajnimit, duke ofruar rekomandimet si në vijim:

42. Nga sa u tha më sipër, KKGJE rekomandon:

i. që programet dhe metodat e trajnimit duhet t'i nënshtrohet vlerësimeve të shpeshta nga organet përgjegjëse për trajnimin gjyqësor;

ii. që, në parim, pjesëmarrja në iniciativat për trajnimin e gjyqtarëve nuk duhet t'i nënshtrohet vlerësimit cilësor; vet pjesëmarrja e tyre, shikuar në mënyrë objektive, mund megjithatë të merret në konsideratë për vlerësimin profesional të gjyqtarëve;

iii. që performanca cilësore e vijuesve të trajnimit duhet sidoqoftë të vlerësohet, nëse vlerësimi i tillë është bërë i nevojshëm nga fakti se, në disa sisteme, trajnimi fillestar është një fazë në procesin e rekrutimit.

Dokument tjetër i rëndësishëm i KKPE është gjithashtu **Opiniononi #13 i KKPE, Pavarësia, llogaridhënia dhe etika e prokurorëve**.<sup>12</sup> Rekomandimi i KKPE kërkon që "Vendet anëtare, ndërsa sigurojnë respektimin e balansit gjinor, duhet të sigurohen që **prokurorët** të përzgjidhen në bazë të shkathtësive dhe vlerave morale dhe etike të tyre, dhe të marrin **trajnimin adekuat fillestar dhe trajnimin gjatë shërbimit** për të ushtruar funksionin e tyre me pavarësi, paanshmëri, llogaridhënie dhe respektim të plotë të standardeve etike. Ata duhet ta mundësojnë ofrimin e informatave dhe këshillave përkatëse prokurorëve për këto çështje."

## OSBE

Rekomandimet e Kievit nga viti 2010 për pavarësinë e gjyqësorit në Evropën Lindore, Kaukazin e Jugut dhe Azinë Qendrore, veçanërisht pikat 19 dhe 20:

---

<sup>12</sup> <https://rm.coe.int/opinion-13-ccpe-2018-2e-independence-accountability-and-ethics-of-pros/native/1680907e9d>

*“Përmirësimi i Trajnimit Special të Gjyqtarëve*

19. Aty ku shkollat për gjyqtarë janë pjesë e procedurave të përzgjedhjes, ato duhet të jenë të pavarura nga pushteti ekzekutiv. Programet e trajnimit duhet të fokusohen në atë që nevojitet në shërbimin gjyqësor dhe të plotësojnë arsimin universitar. Ato duhet të përfshijnë aspekte të etikës, aftësitë e komunikimit, aftësinë për të zgjidhur mosmarrëveshjet, aftësitë e menaxhimit dhe aftësitë e shkrimit ligjor. Kur ekziston një Këshill Gjyqësor, ai mund të miratojë rekomandime për arsimimin ligjor të gjyqtarëve. Kjo përfshin specifikimin e aftësive dhe këshillave përkatëse për arsimimin e vazhdueshëm të gjyqtarëve.

20. Trajnimi i posaçëm siç përmendet në paragrafin 19 duhet të ofrohet edhe për përfaqësuesit e profesioneve të tjera ligjore që i bashkohen gjyqësorit.”

### **Organizata Ndërkombëtare për Trajnimin Gjyqësor (IOJT)**

Deklarata e Parimeve të Trajnimit Gjyqësor nga viti 2017, veçanërisht Parimi 2:

“Parimi 2. Për të ruajtur pavarësinë e gjyqësorit, gjyqësori dhe institucionet e trajnimit gjyqësor duhet të jenë përgjegjës për hartimin, përmbajtjen dhe ofrimin e trajnimit gjyqësor.

Pavarësia e gjyqësorit kërkon lirinë nga ndikimi i padrejtë ose i pahijshëm mbi trajnimin gjyqësor. Duke pasur parasysh se seminarët dhe burimet, të tilla si librat, kanë potencialin për të ndikuar në sjelljen dhe vendimet e gjyqtarëve, përmbajtja dhe ofrimi i trajnimit gjyqësor duhet të ofrohet pa ndikime të panevojshme ose të pahijshme nga çdo subjekt që mund të përfitojë, duke përfshirë autoritetet financuese, ligjvënësit, drejtuesit e qeverisë, të fuqishmit politikisht dhe financiarisht dhe të tjerë.”

### **Bashkimi Evropian**

Në nivel të Bashkimit Evropian, një nga dokumentet që kërkon vëmendje është Konkluzionet e Këshillit ‘Trajnimi i praktikuesve ligjor: një mjet thelbësor për të konsoliduar *acquis* e BE-së’.<sup>13</sup> Ndonëse Kosova nuk mbulohet me këtë Konkluzion të Këshillit, disa nga kërkesat përcaktojnë teori që do të ishin me interes për Kosovën për shkak të investimit të saj në procesin e integritimit në BE; posaçërisht kërkesa për të “[i]ntegruar në mënyrë sistematike trajnimin për ligjet e BE dhe veçanërisht në Kartën e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore [...]”

---

<sup>13</sup> [https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/HTML/?uri=CELEX:52014XG1211\(01\)&from=EN](https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/HTML/?uri=CELEX:52014XG1211(01)&from=EN)



**Rrjeti Evropian për Trajnim Gjyqësor (EJTN)** është platforma dhe nxitësi themelor për trajnimin dhe shkëmbimin e njohurisë së gjyqësorit evropian. Ai krijon standarde dhe kurrikula të trajnimit, koordinon shkëmbimet dhe programet e trajnimeve të gjyqësorit, shpërndanë ekspertizën e trajnimit dhe promovon bashkëpunimin në mes institucioneve gjyqësore të BE-së. Si e tillë, është platformë e pasur dhe përmban shumë informata lidhur me praktikën më të mira të trajnimit në mes anëtarëve të saj.<sup>14</sup>

Në vitin 2016 EJTN ka miratuar Nëntë parimet e trajnimit gjyqësor<sup>15</sup>

EJTN ka përgatitur dhe ka publikuar seritë e doracakëve dhe instrumenteve metodologjik ku përmbledhen praktikën e mira të Shteteve anëtare të BE-së, siç janë Udhëzuesi për Metodën e Trajnimit Gjyqësor për Vlerësimin e Praktikave të Trajnimit Gjyqësor<sup>16</sup> dhe Manualin e EJTN për Metodologjinë e Trajnimit Gjyqësor në Evropë dhe të tjera.<sup>17</sup>

### 1.3 Shtetet në rajon

Sa i përket legjislacioni të shteteve në rajon, shumica e tyre kanë rregulluar çështjen e institucioneve të specializuara për të ofruar shërbime të trajnimit për gjyqtarë dhe prokurorë me ligje të veçanta.

Pjesa me poshtë, do të jap të dhëna shtesë në lidhje me statusin juridik të këtyre institucioneve, organet drejtuese, si dhe llojin e trajnimeve që ofrojnë.

## Shqipëria

Republika e Shqipërisë e ka të rregulluar çështjen e trajnimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve me Ligjin Nr. 115/2016 për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë.<sup>18</sup> Pjesa VI e këtij Ligji rregullon çështjet që kanë të bëjnë me Shkollën E Magjistraturës.

---

<sup>14</sup> <http://www.ejtn.eu/Resources/Good-judicial-training-practices/>

<sup>15</sup> [https://www.ejtn.eu/PageFiles/15756/Judicial%20Training%20Principles\\_EN.pdf](https://www.ejtn.eu/PageFiles/15756/Judicial%20Training%20Principles_EN.pdf)

<sup>16</sup> [http://ëë.ejtn.eu/PageFiles/17381/EJTN\\_JTM%20Guidelines%20for%20Evaluation%20of%20judicial%20Training%20Practices%20Handbook%202017.pdf](http://ëë.ejtn.eu/PageFiles/17381/EJTN_JTM%20Guidelines%20for%20Evaluation%20of%20judicial%20Training%20Practices%20Handbook%202017.pdf)

<sup>17</sup> [http://www.ejtn.eu/Documents/EJTN\\_JTM\\_Handbook\\_2016.pdf](http://www.ejtn.eu/Documents/EJTN_JTM_Handbook_2016.pdf)

<sup>18</sup> <https://www.magjistratura.edu.al/sq/korniza-ligjore>

Në lidhje me statusin e Shkollës së Magjistraturës, Ligji përcakton se Shkolla e Magjistraturës gëzon autonomi administrative, akademike dhe financiare për realizimin e qëllimeve dhe të detyrave të caktuara në këtë ligj. Ligji nuk përcakton se kujt i raportin Shkolla e Magjistraturës.

Ne lidhje me organet drejtuese, Shkolla e Magjistraturës ka Këshillin Drejtues, Drejtorin e Shkollës, Këshillin Pedagogjik dhe Komisionin Disiplinor.

Përbërja e Këshillin Drejtues është si vijon:

- a) Kryetari i Gjykatës së Lartë, i cili kryen njëkohësisht funksionin e Kryetarit të Këshillit Drejtues;
- b) Prokurori i Përgjithshëm, i cili kryen njëkohësisht funksionin e Zëvendëskryetarit të Këshillit Drejtues;
- c) Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor;
- ç) Kryetari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë;
- d) një gjyqtar dhe një prokuror me përvojë, që caktohen, sipas rastit, përkatësisht nga mbledhja e përgjithshme e të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve. Anëtarët e zgjedhur nga radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve nuk mund të jenë njëkohësisht anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor ose anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë;
- dh) dy përfaqësues të caktuar nga Ministri i Drejtësisë;
- e) Avokati i Përgjithshëm i Shtetit;
- ë) Kryetari i Dhomës Kombëtare të Avokatisë;
- f) një përfaqësues i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, me përvojë të spikatur në fushën juridike;
- g) Drejtori i Shkollës së Magjistraturës;
- gj) përgjegjësit e trajnimit fillestar dhe vazhdues, si dhe dy pedagogë të brendshëm të Shkollës së Magjistraturës;
- h) dy studentë nga vite akademike të ndryshme të zgjedhur me votim të fshehtë nga asambleja e kandidatëve për magistratë që ndjekin formimin fillestar.

Mandati i anëtarëve Anëtarët e Këshillit Drejtues, përveç anëtarëve sipas funksionit, zgjat katër (4) vite pa të drejtë për rizgjedhje. Ky mandate iu ndërpritet në rastet kur nuk ushtrojnë më funksionin ose detyrën, që motivon caktimin e tyre si anëtarë të Këshillit.

Sa i përket trajnimeve, Shkolla e Magjistraturës ofron trajnime fillestare për kandidatët për gjyqtarë, prokurorë **dhe avokatët shtetëror**, dhe trajnime të vazhdueshme për gjyqtarë dhe prokurorë. Duhet theksuar se në Republikën e Shqipërisë, kandidatët për

gjyqtarë dhe prokurorë, vijojnë një program të gjatë trajnimi prej tre (3) viteve para se të emërohen me dekret si gjyqtarë apo prokurorë.

## **Maqedonia e Veriut**

Republika e Maqedonisë së Veriut e ka të rregulluar çështjen e trajnimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve me Ligjin për Akademinë për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë,<sup>19</sup> me të cilin themelohet Akademia për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë si institucion publik për pranim dhe përsosje profesionale të kandidatëve për gjykatës dhe prokurorë publikë, trajnimi i vazhdueshëm dhe përparimi i profesionalizmit të gjykatësve dhe prokurorëve publikë, trajnimi i vazhdueshëm i shërbimeve profesionale në gjyqësi dhe prokurori publike, trajnimi i subjekteve të cilët marrin pjesë në zbatimin e ligjeve nga sfera e jurisprudencës.

Në lidhje me statusin juridik, Ligji i jep pavarësi funksionale Akademisë, megjithatë përcakton se Ministrinë e Drejtësisë si institucion që mbikëqyr zbatimin të dispozitave të Ligjit për Akademinë.

Këshilli Drejtues është organ i menaxhimit të Akademisë dhe përbëhet nga nënte (9) anëtarë, prej të cilëve katër (4) i propozon Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë dhe katër (4) tjerë i propozon Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë. Kurse anëtarin e fundit, e emëron Ministri i Drejtësisë nga radhët e nëpunësve administrativë udhëheqës në Ministrinë e Drejtësisë.

Nga Këshilli Gjyqësor emërohen nga një anëtar nga radhët e gjykatësve të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë, nga gjykatat e apelit, nga gjykatat themelore, si dhe një anëtar nga Gjykata Administrative ose nga Gjykata e Lartë Administrative.

Nga Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë emërohen nga një anëtar nga radhët e prokurorëve publikë në Prokurorinë Publike të Republikës së Maqedonisë, nga prokuroritë e larta publike, nga prokuroritë themelore publike dhe nga Prokuroria Themelore Publike për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Në punën e Këshillit Drejtues merr pjesë edhe drejtori i Akademisë pa të drejtë vote.

---

<sup>19</sup> <https://jpacademy.gov.mk/wp-content/uploads/2021/07/ligji-agjpp-nr.-20-nga-2015.pdf>

Sa i përket trajnimeve Akademia organizon trajnim fillestar dhe të vazhdueshëm. Trajnimi fillestar organizohet për kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë dhe vlerësimi i tyre kryhet nga Akademia. Numri i pjesëmarrësve në trajnime fillestare caktohet nga Këshilli Gjyqësor dhe ai i Prokurorëve Publik.

Me marrjen e statusit të ndjekësit të trajnimit fillestar në Akademi, pjesëmarrësi krijon marrëdhënie pune në kohë të caktuar në Akademi për periudhën e zbatimit të trajnimit fillestar deri në zgjedhjen e kandidatit për gjykatës ose prokuror publik, për gjykatës në gjykatë themelore, respektivisht për prokuror publik në prokurorinë publike themelore. Gjatë kohëzgjatjes së marrëdhënies së punës nga paragrafi (1) i këtij neni, kandidati për gjykatës ose prokuror publik ka të drejtë page të këshilltarit të lartë gjyqësor në gjykatë themelore dhe kompensime tjera të pagës në pajtim me ligjin. Nëse kandidati gjatë trajnimit fillestar heq dorë ose e ndërpret trajnimin, obligohet që t'i kompensojë shpenzimet dhe kompensimet tjera për trajnimin e tij sipas përlllogaritjes së përcaktuar nga ana e Akademisë.

## **Serbia**

Edhe Serbia e ka të miratuar Ligjin për Akademinë e Drejtësisë<sup>20</sup>, përmes së cilit përcakton se themelues i Akademisë së Drejtësisë është Republika e Serbisë dhe gëzon statusin e personit juridik. Ministria e Drejtësisë mbikëqyr zbatimin të dispozitave të Ligjit për Akademinë e Drejtësisë.

Organet drejtuese të Akademisë janë Këshilli Drejtues, Drejtori dhe Këshilli Programor.

Këshilli Drejtues është organi që menaxhon Akademinë dhe përbëhet nga nëntë (9) anëtarë, katër (4) anëtarë të emëruar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor nga radhët e gjyqtarëve; dy (2) anëtarë të emëruar nga Këshilli i Prokurorit të Shtetit nga radhët e prokurorëve, dhe tre (3) anëtarë të emëruar nga Qeveria, njëri prej të cilëve Sekretar i Shtetit në Ministrinë e Drejtësisë i ngarkuar me ngritjen profesionale të personelit gjyqësor dhe një nga personeli i Akademisë.

Anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit Shtetëror të Prokurorëve nuk mund të jenë anëtarë të Këshillit Drejtues.

---

<sup>20</sup> <https://www.paragraf.rs>

Në aspekt të trajnimeve, Akademia e Drejtësisë ofron trajnime fillestare për kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë dhe bën vlerësimin e tyre, si dhe trajnime të vazhdueshme për gjyqtarët dhe prokurorë.

Përfituesi i trajnimit fillestar punësohet për një periudhë 30 mujore në Akademi, derisa gjykata, përkatësisht prokuroria publike, në të cilën përfituesi i trajnimit fillestar do të kryejë trajnimin fillestar. Përfituesi i trajnimit fillestar ka pagë në masën 70% të pagës bazë të gjyqtarit të gjykatës themelore, për kohëzgjatjen e punësimit me afat të caktuar në Akademi dhe ndjekja e trajnimit fillestar konsiderohet përvojë pune në profesionin e juristit.

Pas përfundimit të trajnimit fillestar, përfituesi i trajnimit është i obliguar të aplikojë për pozitën e gjyqtarit të gjykatës për kundërvajtje ose gjykatës themelore, përkatësisht zëvendës prokurorit publik themelor.

## **Kroacia**

Republika e Kroacisë ka Ligjin për Akademinë e Drejtësisë,<sup>21</sup> përmes së cilit themelon Akademinë e Drejtësisë. Themelues i Akademisë është Republika e Kroacisë, ndërsa të drejtat dhe detyrat e themeluesit i kryen Qeveria e Republikës së Kroacisë përmes Ministrisë së Drejtësisë. Pra edhe këtu rezulton se Ministria e Drejtësisë mbikëqyrë në një farë mënyrë Akademinë e Drejtësisë.

Organet drejtuese të Akademisë janë Këshilli Drejtues, Drejtori dhe Këshilli Programor.

Akademia menaxhohet nga Këshilli Drejtues dhe përbëhet nga pesë anëtarë të përhershëm dhe dy anëtarë të cilët emërohen për një mandat katër vjeçar.

Pesë (5) anëtarët e përhershëm të Këshillit Drejtues janë: i) Kryetar i Gjykatës Supreme, ii) Kryeprokurori i Shtetit, iii) Kryetari i Këshillit Gjyqësor, iv) Kryetari i Këshillit të Prokurorisë së Shtetit, dhe v) Ministri i Drejtësisë.

---

<sup>21</sup> [Zakon o Pravosuđnoj akademiji - Zakon.hr](#)

Kurse, dy (2) anëtarët e Këshillit Drejtues të cilët emërohen për një mandat katër vjeçar janë një (1) përfaqësues i profesorëve të universitetit të shkencave juridike dhe një (1) përfaqësues i punonjësve të Akademisë.

Sa i përket trajnimeve fillestare, brenda Akademisë është themeluar edhe Shkolla Shtetërore për shërbyesit civil në sistemin e drejtësisë, të cilën duhet ta ndjekin personat e pranuar në shërbimin civil në ndonjë institucion të sistemi të drejtësisë. Ky program trajnimi zgjat tre (3) vite dhe me përfundimin e së cilës und të konkurrojnë për bartës të funksioneve gjyqësore. Shkolla përfundohet me kalimin e suksesshëm të provimit përfundimtar. Provimit përfundimtar në Shkollë mund t'i nënshtrohen edhe personat që nuk e kanë ndjekur shkollën dhe që kanë punuar në çështjet juridike për të paktën katër vjet pas dhënies së provimit të jurisprudencës.

Akademia ofron edhe trajnime të vazhdueshme për gjyqtarë dhe prokurorë. Me ligj është përcaktuar se programi dhe zhvillimi profesional i bartësve të funksioneve gjyqësore është i strukturuar në atë mënyrë që, si rregull, materia juridike në kuadër të programit vjetor të formimit profesional përfaqësohet me 40%, modulet me tema ndërdisiplinore me 30% dhe ngritja e aftësive sociale dhe praktike me 30%.

#### 1.4 Korniza e politikave dhe e legjislacionit të Kosovës

Në Republikën e Kosovës, ekziston një nivel i normimit lidhur me trajnimet gjyqësore dhe çështjet tjera të ndërlidhura me ngritjen e kapaciteteve. Kjo kornizë ligjore, e cila është objekt elaborimi edhe në tabelën e mëposhtme, përbëhet nga aktet ligjore si në vijim:

1. *Ligji për Akademinë e Drejtësisë*
2. *Ligji për Gjykatat*
3. *Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës*
4. *Ligji për Prokurorin e Shtetit*
5. *Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës*
6. *Ligji për Avokatinë*
7. *Ligji për Noterinë*
8. *Ligji për Procedurën Përmbarimore*
9. *Ligji për Ndërmjetësim*
10. *Ligji për Falimentimin*

11. *Ligji për Administratën Shtetërore dhe Agjencitë e Pavarura*
12. *Ligji për Gjykatën Komerciale*
13. *Ligji për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve*

*Figura 2: Dokumentet përkatëse të politikave, ligjet dhe aktet nënligjore*

Dokument i politikave, ligj ose akti nën-ligjor	Lidhja me Gazetën Zyrtare	Institucioni(-et) shtetëror (e) përgjegjës(e) për zbatim	Roli dhe detyrat e Institucionit(-eve)
Ligji për Akademinë e Drejtësisë	<a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=13318">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=13318</a>	Akademia e Drejtësisë (AD)	AD harton programet e trajnimit dhe organizon trajnimet për gjyqtarë dhe prokurorë të shtetit, për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial, si dhe mund të organizojë trajnime të vazhdueshme profesionale për avokat shtetëror, avokat, noter, përmbarues privat, ndërmjetësues, administratorët falimentues, si dhe profesione tjera në bazë të vlerësimeve të Akademisë, sipas kërkesave të institucioneve kompetente.
Ligji për Gjykatat	<a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18302">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18302</a>	KGJK, Gjykatat e Kosovës	<p>Ligji për Gjykata përcakton se trajnimi fillestar organizohet dhe zhvillohet nga AD për gjyqtaret të cilët pas emërimit nga Presidenti i Kosovës, i nënshtrohen trajnimit fillestar.</p> <p>Në këtë ligj, po ashtu ceket se gjyqtarët e emëruar do të vlerësohen pas rezultateve të trajnimit fillestar, në përputhje me dispozitat relevante të këtij ligji.</p> <p>Më tutje ky Ligj nuk flet për trajnime të vazhdueshme të gjyqtarëve.</p>
Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës	<a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18335">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18335</a>	KGJK	Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës përcakton kompetencat e KGJK në raport me trajnimin e gjyqtarëve. Sipas këtij ligji, KGJK vendos dhe mbikëqyrë kriteret për përcaktimin e politikave, standardeve dhe udhëzimeve lidhur me trajnimin e gjyqtarëve, gjyqtarëve porotë dhe



			<p>personelit tjetër gjyqësorë dhe mbikëqyrjen e zbatimit të trajnimit profesional të gjyqtarëve dhe gjyqtarëve porotë.</p> <p>Për më tepër, ky Ligj përcakton se KGJK në bashkërendim me Akademinë e Drejtësisë përcakton politikat, standardet dhe udhëzimet për rregullimin e trajnimit të gjyqtarëve, gjyqtarëve porotë dhe stafit administrativ duke përfshirë edhe trajnimin fillestar.</p>
Ligji për Prokurorin e Shtetit	<a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2710">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2710</a>	KPK, Prokuroritë e Kosovës	<p><b>Ky</b> Ligj përcakton se prokurorët kanë të drejtë në trajnim profesional të duhur për t'iu mundësuar ushtrimin efektiv të funksioneve të tyre prokuroriale, siç është e përcaktuar nga Këshilli.</p> <p>Për më tepër, Kryeprokurori i Shtetit, së bashku me Këshillin, shqyrton programet trajnuese për prokurorët dhe bën përmirësime të nevojshme për të siguruar përshtatjen, efikasitetin dhe dobinë.</p>
Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës	<a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18920">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18920</a>	KPK, Prokuroritë e Kosovës	<p>Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës përcakton kompetencat e KPK në raport me trajnimin e prokurorëve. Sipas këtij ligji, KPK vendos dhe mbikëqyrë kriteret për përcaktimin e politikave, standardëve dhe udhëzimeve sa i përket trajnimit të prokurorëve dhe personelit tjetër dhe mbikëqyrjen e zbatimit të trajnimit dhe zhvillimit profesional të prokurorëve nga Akademia apo shoqata apo organizata tjera trajnuese .</p> <p>Për më tepër, ky Ligj përcakton se KPK në bashkërendim me Akademinë e Drejtësisë përcakton politikat, standardet dhe udhëzimet për rregullimin e trajnimit të prokurorëve dhe stafit tjetër të prokurorive.</p>
Ligji për Avokatinë	<a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8673">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8673</a>	Oda e Avokateve, avokatët	Ligji për Avokatinë përcakton se avokatet janë të detyruar të arsimohen në mënyrë të vazhdueshme dhe të pasurojnë njohuritë për ushtrimin e avokatisë në pajtim me aktet e përgjithshme të Odës.

Ligji për Noterinë	<a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2595">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2595</a>	MD, Oda e Noterëve	<p>Ligji për Noterinë i jep kompetencë Odes se Noterëve për organizimin e trajnimeve për noterë. Ky Ligj përcakton se funksionet primare të Odes është edhe organizimi i trajnimit të noterëve dhe punëtorëve të zyrave të noterisë.</p> <p>Për më tepër, Ky Ligj përcakton se pas licencimit të noterit, Oda brenda afatit dhjetë (10) ditësh është e detyruar të organizoj trajnim gjashtë (6) mujor për noterë. Oda në afat prej dy(2) ditësh pas përfundimit të trajnimit njofton Ministrinë e Drejtësisë për përfundimin e trajnimit për noter.</p>
Ligji për Procedurën Përmbaremore	<a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2870">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2870</a>	MD, Gjykatat, Përmbareuesit Privat	Ligji për Procedurën Përmbaremore përcakton mënyrën e emërimit dhe licencimit përmbareuesve privat, ndonëse nuk ka ndonjë dispozite specifike që sanksionin trajnimin e vazhdueshëm të përmbareuesve privat.
Ligji për Ndërmjetësim	<a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2592">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2592</a>	MD, Ndërmjetësit	<p>Ligji për Ndërmjetësim përcakton kushtet dhe mënyrën e emërimit të ndërmjetësuesve. Në aspekt të trajnimit, ky Ligj përcakton se ndërmjetësues mund të jete çdo person i cili ka kaluar me sukses trajnimin për ndërmjetësim, përfshirë edhe zgjidhjen e rasteve praktike në kuadër të trajnimit dhe nën mbikëqyrjen e një ndërmjetësuesi të licencuar.</p> <p>Me tutje, ky Ligj përcakton se trajnimet për ndërmjetësues i organizon Ministria e Drejtësisë.</p>
Ligji për Falimentimin	<a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12664">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12664</a>		Ky Ligj përcakton si një ndër kriteret ligjore për t'u emëruar si administrator për falimentim është edhe se kandidati duhet të ketë të përfunduar trajnime profesionale për veprimtaritë e bizneseve, menaxhimin ose mbylljen e tyre. Megjithatë, Ligji dëshon të identifikojë organin i cili duhet të organizoj këtë lloj të trajnimit.

Ligji për Administratën Shtetërore dhe Agjencitë e Pavarura	<a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18684">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18684</a>	Qeveria, Kuvendi,	Ky Ligj përcakton kritere për themelimin e një Agjencie Ekzekutive ose të Pavarur si pjesë përbërëse e Ministrisë.
<i>Ligji për Gjykatën Komerciale</i>	<a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=53748">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=53748</a>	KGJK, Gjykata Komerciale, Akademia e Drejtësisë,	Ky Ligj përcakton kompetenca Kryetarit të Gjykatës Komerciale në lidhje me trajnimin e personelit, përkatësisht që t'i i propozojë një program të rregullt dhe të vazhdueshëm të trajnimit gjyqësor, që adreson zhvillimet materiale juridike dhe praktikat relevante komerciale.  Për më tepër, në këtë Ligj po ashtu caktohet kriteret për trajnim të detyrueshëm fillestar për gjyqtarët që do të zgjasë dymbëdhjetë (12) muaj, nga i cili një periudhë minimale prej gjashtë (6) muajsh do t'i kushtohet trajnimit të detyrueshëm fillestar për të drejtën komerciale.
<i>Ligji për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve</i>	<a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18336">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18336</a>	KGJK, KPK,	Ky Ligj përcakton rastet kur KGJK dhe KPK mund të detyrojnë ndonjë bartës të funksionit gjyqësor ose prokurorial në vijim të ndonjë trajnimi, si dhe e përcakton si vetë shkelje disiplinore situatën kur gjyqtarit ose prokurorit nuk vijon në vazhdimësi, pa justifikim të arsyeshëm, në programet e detyrueshme trajnuese të përcaktuara me ligj ose me rregulloret dhe politikat e Këshillave.

## 1.5 Elaborimi i problemit kryesor

Çështjet që ndërlidhen me trajnimin dhe ngritjen e kapaciteteve të gjyqtarëve dhe prokurorëve, personelin mbështetës profesional të tyre dhe profesioneve të lira<sup>22</sup>, janë të karakterit organizativ dhe të bashkëpunimit ndër-institucional, por në të njëjtën kohë kërkojnë trajtimin edhe nga aspekti legjislativ në mënyrë që kjo sferë mjaft e rëndësishme e sistemit të drejtësisë të avancohet edhe me tutje dhe të jetë në gjendje të përgjigjet ndaj nevojave të sistemit gjyqësor dhe atij prokurorial si në aspektin e trajnimeve fillestare po ashtu edhe në kuptim të trajnimeve të vazhdueshme si edhe ato për specializimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

### 1.5.1 Statusi i Akademisë

Një ndër çështjet që më së shpeshti është diskutuar dhe tentuar që të ndryshohet është statusi juridik i Akademisë së Drejtësisë, mirëpo që deri me sot një solucion me të qëndrueshëm nuk ka pasur.

Statusi aktual që e ka Akademia, është organ i themeluar nga Kuvendi dhe që i raporton Kuvendit, përkatësisht Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit (Komisionit për Legjislacion).

Disa nga tentativat e fundit përfshijnë edhe kalimin e Akademisë së Drejtësisë si Agjenci ekzekutive e Ministrisë së Drejtësisë. Po ashtu ka pasur edhe propozime dhe ide që e njëjta të vendoset nën “menaxhim” të dy këshillave, respektivisht Këshillit Gjyqësor dhe atij Prokurorial.

Fillimisht duhet theksuar se parimet dhe standardet ndërkombëtare dhe evropiane të trajnimit gjyqësor kërkojnë që institucioni trajnues i sistemit të drejtësisë të jetë i pavarur nga funksionet e tij nga pushteti ekzekutiv dhe legjislativ, si dhe nga organet në kompetente për emërimin dhe disiplinimin të gjyqtarëve. Duke qenë së një kërkesë e tillë për kuadrin normativ ligjor të Kosovës është vështirë të gjendet një solucion lehtësisht i zbatueshëm dhe i qëndrueshëm, më tutje ky Koncept Dokument do të elaborojë këto propozime në mënyrë që të kontribuojnë në një vendim-marrje më të mirinformuar sa i përket statusit të Akademisë së Drejtësisë.

---

<sup>22</sup> Noterët, përmbauesit privat, ndërmjetësit.

## *Vendosja e Akademisë së Drejtësisë nën pushtetin ekzekutiv*

Propozimi fillestar që Akademia të zhvendoset si agjenci ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, ngërthen në vete disa çështje problematike.

Së pari, futja nën ombrellën e Ministrisë së Drejtësisë, do të nënkuptonte që një ndër komponentët kryesorë të zhvillimit të karrierës së gjyqtarëve dhe prokurorëve do të ishte kompetence e pushtetit ekzekutiv. Kalimi i kësaj komponentë të rëndësishme nën Ministrinë e Drejtësisë, do të ishte në kundërshtim me këto kërkesa që dalin nga standardet ndërkombëtare.

Për më tepër, edhe Ligji për Administratën Shtetërore dhe Agjencitë e Pavarura paraqet një pengese ligjore në funksionalizmin e kësaj ideje. Neni 12 i Ligjit përcakton se:

1. Agjencia Ekzekutive themelohet për të kryer funksionet administrative brenda fushës së përgjegjësisë shtetërore të një ministrie apo Zyrës së Kryeministrit, si në vijim:

1.1. zbatimin e ligjit, duke zgjidhur çështje individuale dhe duke kryer veprime administrative sipas Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative;

1.2. mbledhjen e tatimeve, taksave, detyrimeve doganore, kontributeve apo detyrimeve të tjera dhe menaxhimin e tyre për qëllimin për të cilin janë krijuar;

1.3. mbrojtjen e sigurisë publike nëpërmjet ushtrimit të autorizimeve policore, dhënien e lejeve, licencave, autorizimeve dhe miratimeve për veprimtari ekonomike specifike dhe kryerjen e inspektimeve;

1.4. mbledhjen, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave dhe informacionit për Qeverinë;

1.5. ushtrimin e përbashkët të funksioneve të brendshme mbështetëse.

2. Agjencia Ekzekutive themelohet me ligj

Duke qenë se Akademia e Drejtësisë, si *“institucion publik i pavarur me cilësinë e personit juridik”*, nuk përmbush asnjë nga pikat 1.1 deri në 1.5 për të arsyetuar themelimin apo vendosjen e një institucioni nën ndonjë Ministri.

Akademia e Drejtësisë, në kompetencë të saj ka ofrimin e trajnimeve fillestare dhe të vazhdueshme për gjyqtarë dhe prokurorë, dhe nuk ka në kompetencë asnjë pjesë që merret me zgjidhjen e çështje individuale dhe duke kryer veprime administrative sipas Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, apo mbledhjen e tatimeve, taksave, detyrimeve doganore, kontributeve apo detyrimeve të tjera, apo mbrojtjen e sigurisë

publike nëpërmjet ushtrimit të autorizimeve policore, dhënien e lejeve, licencave, autorizimeve dhe miratimeve për veprimtari ekonomike specifike dhe kryerjen e inspektimeve.

Si rrjedhojë çdo tentative për ta vendosur Akademinë e Drejtësisë nën ombrellën e Ministrisë së Drejtësisë do të ishte në shkelje të Ligjit për Administratën Shtetërore dhe Agjencitë e Pavarura.

#### *Vendosja e Akademisë së Drejtësisë nën pushtetin legjislativ*

Siç e cekem më lartë, Akademia e Drejtësisë është organ i themeluar nga Kuvendi dhe që i raporton Kuvendit, përkatësisht Komisionit për Legjislacion. Mirëpo, edhe ky propozim ka një pengesë ligjore. Në lidhje me themelimin e Agjencive të pavarura (ashtu siç e ka statusin aktual Agjencia), Ligji për Administratën Shtetërore dhe Agjencitë e Pavarura (neni 38) përcakton se:

1. Agjencitë e pavarura themelohen me ligj në bazë të nenit 142 të Kushtetutës.
2. Një agjenci e pavarur mund të themelohet, sipas paragrafit 1 të këtij neni, për të kryer kompetenca, që plotësojnë së bashku këto kushte:
  - 2.1. nuk janë pjesë e kompetencave të pushtetit ekzekutiv të Qeverisë sipas Kushtetutës, dhe
  - 2.2. i shërbejnë Kuvendit për ushtrimin e mbikëqyrjes/kontrollit parlamentar të specializuar të ligjshmërisë dhe integritetit në fusha të caktuara të veprimtarisë administrative.

Në këndvështrim të këtij Ligji rezulton se Akademia e Drejtësisë nuk do mund të themelohet si agjenci e pavarur sipas neni 142 të Kushtetutës, sepse duhet përmbushur të dyja kushtet në aspektin kumulativ, që të mund të themelohet një agjenci e pavarur. Në rastin e Akademisë së Drejtësisë, derisa kushti i parë (paragrafi 2.1, i nenit 38) përmbushet, çështje problematike paraqet përmbushja e kushtit të dytë që ka të bëjë me mbikëqyrjen/kontrollin parlamentar të specializuar të ligjshmërisë dhe integritetit në fusha të caktuara të veprimtarisë administrative. Në rastin konkret, Akademia e Drejtësisë nuk mund të i ofrojë Kuvendit prerogativa mbikëqyrëse apo të bëjë kontroll parlamentar të ligjshmërisë dhe integritetit në fusha të caktuara të veprimtarisë administrative.

Nuk mund të thuhet se Akademia e Drejtësisë do të i mundësojë mbikëqyrje Kuvendit ashtu që për shembull përmes vëllimit dhe cilësisë së trajnimeve të shihet se sa ka ndikuar në ngritjen e efikasitetit, llogaridhënies dhe transparencës së punës së gjyqtarëve dhe prokurorëve në veçanti dhe sistemit gjyqësor dhe prokurorial në përgjithësi.

*Vendosja e Akademisë së Drejtësisë nën KGJK dhe KPK*

Propozimi tjetër që Akademia të menaxhohet nga i) të dy Këshillat apo ii) nga një Bord i përbashkët të emëruar nga Këshilli Gjyqësor dhe ai Prokurorial përbën një tjetër propozim i cili duhet të konsiderohet me më seriozitet ndërmjet këtij solucioni dhe dy solucioneve të mësipërme.

Fillimisht, ndjekja e këtij propozimi nuk parqet ndonjë konflikt me ndonjë normë ligjore në Kosovë, e që është një ndër premisat bazë për ndryshimin e ligjit aktual, në raport me dy propozimet tjera.

Megjithatë duhet cekur se standardet ndërkombëtare dhe evropiane të trajnimit gjyqësor kërkojnë që institucioni trajnues i sistemit të drejtësisë i) duhet të jetë i pavarur nga funksionet e tij nga pushteti ekzekutiv dhe legjislativ, si dhe ii) nga organet në ndryshimin e emërimit dhe disiplinimit të gjyqtareve dhe prokurorëve, një solucion mes këtyre dy kufizimeve duhet adresuar me kujdes në këtë Koncept Dokument, në mënyrë që çfarëdo statusi të ardhshëm që të ketë Akademia e Drejtësisë duhet që të jetë sa e përafërt me standardet më të mira ndërkombëtare dhe në përputhje të plotë me normat ligjore në fuqi.

## **Rekomandimi**

Duket se zgjidhja më e përshtatshme dhe më adekuate me standardet evropiane dhe ndërkombëtare të cituara më lart, është modeli sipas se cilit Akademia përkufizohet si:

- a) institucion publik i pavarur me cilësinë e personit juridik i themeluar në bazë të nenit 142 të Kushtetutës,
- b) ka buxhetin e vet i cili administrohet në mënyrë të pavarur dhe në përputhje me ligjin për financat publike dhe legjislacionin tjetër përkatës
- c) mbikëqyret nga një Bord Drejtues, i përbërë kryesisht nga përfaqësues të sistemit të drejtësisë, të emëruar nga Kuvendi pas propozimeve nga KGJK dhe KPK si dhe nga Ministria e Drejtësisë dhe nga Komisioni për Legjislacion.

Një solucion i tillë do të ishte edhe në përputhshmëri të plotë me fushë veprimtarinë e Komisionit për Legjislacion Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, pasi që në kuadër të kompetencave të tij

ka edhe "shqyrtimin e çështjeve të gjyqësisë në Kosovë" e që ngritja e kapaciteteve të gjyqtarëve dhe prokurorëve, siç u cek në fillim të këtij Koncept Dokumenti, përben një ndër kompetentët kryesore të sistemit gjyqësor dhe prokurorial në Kosovë.

### 1.5.1 Organet Drejtuese

Organet Drejtuese të Akademisë janë Këshilli Drejtues, Këshilli Programor dhe Drejtori Ekzekutiv. Ky Koncept Dokument do të shtjellojë secilin organ veçanërisht, për të vënë në pah disa nga çështjet që kërkojnë adresim imediat.

#### - Këshilli Drejtues

Përbërja e Këshillit Drejtues në përgjithësi është adekuate për garantimin e pavarësisë së Akademisë-së. Nga nëntë (9) anëtarë, tetë (8) janë nga sistemi i drejtësisë: dy (2) sipas detyrës zyrtare që janë Kryetari i Gjykatës Supreme dhe Kryeprokurori i Shtetit, kurse gjashtë (6) të tjerë të emëruar nga KGJK/KPK përkatësisht në mesin e gjyqtarëve në detyrë, prokurorëve dhe anëtarëve të dy Sekretariateve, kurse një (1) anëtar emërohet nga Ministri i Drejtësisë.

Nuk shihet ndonjë nevojë të përfshihen profesione të tjera juridike/juridike në Këshill Drejtues, pasi grupet kryesore të synuara mbeten gjyqtarët, prokurorët dhe stafi administrativ mbështetës i tyre. Në anën tjetër, MD-ja që mbikëqyr profesionet e tjera juridike/juridike mund t'i përfaqësojë ato në mënyrë legjitime në organin më të lartë drejtues të Akademisë.

Megjithatë, një opsion i diskutueshëm është rritja e numrit të anëtarëve të emëruar nga KGJK në katër (4) dhe zvogëlimi i numrit të anëtarëve të emëruar nga KPK në dy (2), në mënyrë që të arrihet standardi i "shumicës së gjyqtarëve të zgjedhur nga gjyqtarët" në organin më të lartë drejtues të Akademisë. Kësisoj, KGJK do të ishte e përfaqësuar me katër (4) anëtarë, KPK me tre (3) anëtarë, kurse MD dhe Kuvendi i Republikës me nga një (1) anëtar.

Po ashtu, kohëzgjatja e mandatit të anëtarëve të zgjedhur të Këshillit Drejtues prej katër vitesh, siç është e përcaktuar aktualisht, konsiderohen si shumë të gjata. Një mandat më i shkurtër prej tre vjetësh pa mundësi ri-zgjedhjeje ose një (1) mandat prej dy (2) vitesh me mundësi rizgjedhjeje edhe për vetëm një (1) mandat shtesë prej dy (2) vitesh do të ishte më e sugjerueshme në vend të modelit aktual për të garantuar ripërtëritjen e anëtarëve të Këshillit Drejtues si dhe përfaqësim më të madh.

Kur bëhet fjalë për zgjedhjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve nga të dy Këshillat, është rekomanduar që të ketë një procedurë të hapur, publike dhe transparente, duke përfshirë



mundësinë e aplikimit individual apo nominimit. Ndoshta i modeli i nominimit do duhej ndjekur edhe nga Komisioni për Legjislacioni.

Për më tepër, çështje diskutabile paraqet edhe autoriteti i Bordit Drejtues për nxjerrjen e akteve nënligjore, respektivisht të pajisurit me bazë të qartë ligjorë për nxjerrjen e disa akteve juridike. Aktualisht Ligji për Akademinë e Drejtësisë (neni 10.1.1.) parasheh që Bordi Drejtues “miraton aktet nënligjore të parapara me këtë ligj”.

Praktika tregon se ligji nuk mund të parashikojë të gjitha aspektet e funksionimit të Akademisë që kanë nevojë për rregullim me akte nënligjore. Si shembull nuk ka Rregullore për Trajnimin e Vazhdueshëm pasi që nuk është paraparë me Ligj. E njëjta gjë vlen edhe për aktivitetet botuese të Akademisë të cilat janë të parapara me ligj por pa referencë të qartë në akt nënligjor.

Kjo është arsyeja pse Këshillit Drejtues duhet t'i jepet kompetenca për të miratuar edhe akte të tjera nënligjore të nevojshme për funksionimin e duhur të Akademisë. Për më tepër, kjo është përmendur shprehimisht në Planin e Veprimit të Strategjisë së Sundimit të Ligjit (Kapitulli I.3) i cili parashikon se ligji “i jep AD-së mundësinë për të nxjerrë akte të brendshme rregulluese”.

Megjithatë, në qoftë se qasja e re e institucioneve të Kosovës është që secili akt nënligjor duhet të ketë shprehimisht bazë ligjore, atëherë sugjerohet që Ligji për Akademinë e Drejtësisë të i listojë gjithë ato akte dhe afatet kohore brenda së cilave ato akte nënligjore duhet miratuar nga Bordi Drejtues.

#### - Këshilli Programor

Struktura dhe përbërja aktuale e Këshillit Programor konsiderohet të jetë e pamjaftueshme për larminë në rritje të grupeve të synuara dhe lëndëve, të mbuluara nga Akademia. Përveç drejtorit janë vetëm gjashtë gjyqtarë dhe prokurorë. Konsiderohet se zgjerimi i numrit të anëtarëve të Këshillit Programor duke shtuar përfaqësues të profesioneve të tjera juridike dhe të akademisë është me se i domosdoshëm. Po ashtu, Këshillit Drejtues do duhej t'i mundësohet të krijojë organe ndihmëse si grupet tematike brenda Këshillit Programor.

Praktika e fundit e zbatuar nga Akademia për të plotësuar pozitat e anëtarëve të Këshillit Programor përmes një procedure të hapur dhe publike të aplikimeve dhe nominimeve është për t'u mirëpritur dhe rregulluar siç duhet në Ligj.

Për më tepër, do duhej paraparë edhe një klauzolë ku i ndalohet anëtarëve të Këshillit Programor apo Këshillit Drejtues të jenë të angazhuar në cilësinë e trajnuesit të Akademisë.

Përndryshe, anëtarët e Këshillit të Programit, Këshillit Drejtues, si dhe Drejtori dhe stafi i Akademisë mund të lejohen të veprojnë si trajnerë të përkohshëm vetëm *pro bono* (pa pagesë), nëse i plotësojnë kërkesat për trajnerë.

- Drejtori

Aktualisht Drejtori i Akademisë mund të zgjidhet edhe nga radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Megjithatë, kjo ka hasur në disa pengesa në praktikë pasi që pezullimi i pozitës së gjyqtarit apo prokurorit nuk parashihet me ligjin bazik që rregullon statusin e gjyqtarit apo prokurorit por me ligjin për Akademi.

Për më tepër, pozita e drejtorit është menaxheriale dhe përvoja e kaluar e gjyqtarëve dhe prokurorëve tregon shpesh se u mungojnë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme menaxheriale, veçanërisht kur bëhet fjalë për një institucion trajnimi gjyqësor në një proces të ngritjes së kapaciteteve. Veçanërisht kërkohet që Drejtori të ketë përvojë dhe njohuri mbi sistemin gjyqësor dhe trajnimin gjyqësor në veçanti.

Një nga sugjerimet është që të hiqet mundësia që Drejtori të rekrutohet nga radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve, të paktën për një periudhë kohore, duke marrë parasysh ndryshimet e ardhshme në legjislacion, strukturë, të gjithë mënyrën e organizimit të punës të Akademisë.

Për më tepër, ekziston nevoja për lirimin e drejtorit nga detyrat e përditshme menaxheriale në situatën aktuale të rritjes së ngarkesës së punës, ngritjes së kapaciteteve dhe zhvillimit të institucioneve, duke ruajtur në të njëjtën kohë stabilitetin, punën ekipore dhe vazhdimësinë në menaxhimin e Akademisë.

### **3. Pjesëmarrja e gjyqtarëve dhe prokurorëve në lloje të ndryshme të trajnimit**

Aktualisht ligjet që rregullojnë sistemin gjyqësor dhe Ligji për Akademinë kanë dështuar në dhënien e një përkufizimit të qartë të disa llojeve të trajnimeve dhe qëllimi që ato trajnim shërbejnë.

Se këndejmi, Ligji duhet të japë një përcaktim më të qartë për llojet e ndryshme të trajnimeve, si i) trajnimi fillestar, ii) rastet dhe kushtet për trajnim të detyrueshëm, iii) trajnim për ngritje në detyrë ose specializim, iv) trajnim për emërim në një pozicion drejtues, v) trajnim për anëtarët e organeve drejtuese të sistemit të drejtësisë, dhe vi) trajnime orientuese / fillestare për personelin administrativ etj.

Kjo do të ndihmonte edhe ne qartësimin e situatave se në cilat raste gjyqtarët dhe prokurorët mund të aplikojnë lirisht për trajnim dhe në cilat raste kërkohet autorizim ose detyrim nga eprorët e tyre administrativë ose nga Këshillat. Një minimum dhe një maksimum ditësh trajnimi në vit për gjyqtarët dhe prokurorët do të vendosen për të garantuar qasje relativisht të barabartë në trajnim.

#### 4. Trajnerët dhe mentorët e përhershëm

Një ndër çështjet që diskutohet më së shumtë është edhe statusi i trajnerëve të përhershëm të angazhuar në Akademi. Nga diskutime me hisedarë të ndryshëm, është vënë në pikëpyetje dobia e trajnerëve të përhershëm që janë nëpunës civilë e jo nga radhët e gjyqtarëve apo prokurorëve.

Figura e një trajneri të përhershëm që vjen nga gjykatat dhe prokuroritë, me përvojë profesionale nga fusha **është kritike për suksesin e trajnimit fillestar** ku gjyqtarët dhe prokurorët e rinj/të ardhshëm trajnohen për ushtrimin e duhur të profesioneve të tyre përkatëse. Nëpunësit civilë nuk e kanë dhe nuk mund ta kenë atë lidhje me realitetet në ndryshim të profesioneve të drejtësisë. Shembujt nga vendet e rajonit ku ekziston kjo praktikë vetëm dëshmojnë domosdoshmërinë për ndryshim.

Baza ligjore për trajnerë dhe mentorë parashihet me Ligjin për Akademinë dhe me Rregulloren Nr. 06/2017 për trajnerë dhe mentor të Akademisë së Drejtësisë e aprovuar nga Këshilli Drejtues i AD më 18 korrik 2017. Përzgjedhja e trajnerëve dhe mentorëve është proces që lëviz poshtë-e-lartë në mes KGJK-së, KPK-së dhe Akademisë. Janë dy lloje të trajnerëve: të përhershëm dhe të përkohshëm.<sup>23</sup>

Mënyra e përzgjedhjes së trajnerëve të përhershëm në mesin e gjyqtarëve dhe prokurorëve sipas ligjit<sup>24</sup> vendoset përmes rregullores së KPK-së dhe KGJK-së të cilët pastaj propozohen për aprovim në Këshillin Drejtues të Akademisë për një periudhë një vjeçare me mundësi vazhdimi më së shumti dy herë. Deri më tani, asnjë nga Këshillat nuk ka nxjerrë ndonjë rregullore të brendshme për përzgjedhjen e trajnerëve të përhershëm dhe kriteret për përzgjedhjen e trajnerëve të përhershëm në mesin e gjyqtarëve dhe prokurorëve janë paraparë në Rregulloren e lartcekur të Akademisë e cila

---

<sup>23</sup> Neni 24, Ligji për Akademinë e Drejtësisë

<sup>24</sup> Ibid par.2

ka plotësuar boshllëkun ekzistues<sup>25</sup>, ndonëse jo me një bazë të fortë ligjore , pasi që kjo ishte përgjegjësi e Këshillave.

Kriteret e caktuara aty janë mjaft të përgjithshme, udhëzuese dhe për më tepër nuk ka ndonjë kërkesë për vlerësim të performancës së mirë. Prandaj, duket se përzgjedhja e trajnerëve të përhershëm bazohet në lirinë e veprimit të KGJK-së dhe KPK-së. Duket se kjo mund të jetë arsyeja pse Akademia nuk ka dërguar asnjë kërkesë në KGJK për trajnerë të përhershëm pasi që aktualisht AD-ja nuk ka trajnerë të përhershëm por ka katër vende për këto pozita.

Në anën tjetër, procedura për trajnerë të përhershëm të cilët nuk janë gjyqtar dhe prokuror është bërë sipas rregullave për shërbimin civil. Në bazë të diagramit organizativ, Akademia ka dy trajnerë të përhershëm si shërbyes civil për dy pozita.<sup>26</sup>

Procedura e përzgjedhjes së trajnerëve të përkohshëm parashihet në rregulloren e lartcekur dhe është e bazuar në një proces konkurrues dhe transparent i cili zhvillohet në Akademi dhe aprovohet nga Këshilli Drejtues. Përveç që janë juristë për nga kualifikimi, ka trajnerë edhe me kualifikime të ndryshme, gjithashtu. Megjithatë, tek trajnuesit e përkohshëm nga radhët e zyrtarëve publikë, duhet parë edhe mënyra e angazhimit dhe kompensimit, sidomos në dritë të Ligjit për Zyrtarë Publikë dhe kufizimeve në Ligjin për Financa Publike (neni 80).

Por, çështje më diskutabile mbetet përzgjedhja e trajnerëve të përhershëm ndërmjet gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe mentorëve të cilët aktualisht ato përzgjidhen dhe caktohen nga Këshillat. Ky proces i përzgjedhjes përbën një ndër hallkat kyçe të suksesit të trajnimeve dhe përzgjedhja të behët nga institucione tjera për Akademinë nuk është shumë dobiprurëse.

---

<sup>25</sup> Neni 6 i rregullores nr. 06/2017 për trajnerë dhe mentorë të Akademisë së Drejtësisë parashih që trajneri i përhershëm në radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve të plotësojë kriteret e mëposhtme:

- 1.1. Të kenë përvojë pune si gjyqtarë dhe prokurorë me mandat të përhershëm në fushën ku aplikojnë si trajnerë,
- 1.2. Të ketë njohuri nga didaktika (metodologjia e trajnimit),
- 1.3 Të jetë kreativ në hartimin, zhvillimin dhe zbatimin e programit të trajnimit,
- 1.4. Te ketë aftësi te larta komunikuese,
- 1.5 Njohja e një gjuhe të huaj konsiderohet përparësi,
- 1.6 Të ketë aftësi kompjuterike

<sup>26</sup> <https://ad.rks-gov.net/en/organizational-chart>

Në këtë kontekst, ndryshim është i nevojshëm edhe në lidhje me procedurën për përzgjedhjen dhe miratimin e trajnerëve të përhershëm ndërmjet gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe mentorëve. Për shkak të rolit të tyre kritik për suksesin e Trajnimit Fillestar, si trajnerët ashtu edhe mentorët e përhershëm do të zgjidhen nga Akademia, sipas nevojave të saj metodologjike dhe të trajnimit dhe më pas do të dorëzohen për miratim nga Këshillat.

Për më tepër, këshillohet që Akademisë t'i atribuohet ligjërisht kompetenca për të ofruar udhëzime metodologjike për mentorët pasi ata luajnë një rol kyç në trajnimin fillestar të gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinj ose të ardhshëm. Andaj, duhet parë mundësinë edhe të angazhimit të 'metodologut' të përhershëm të brendshëm, i cili do të këshillojë dhe udhëzojë trajnerët, si ata *ad hoc* dhe të brendshëm, si edhe ata nga gjyqësori ashtu edhe nga jashtë.

Rregulli aktual që trajnerët e përhershëm mund të emërohen për një vit, me mundësi vazhdimi edhe një vit tjetër duhet të ruhet, përndryshe rrezikojnë të shkëputen nga praktika.

Megjithatë ne te ardhmen do duhej të o të parashikohen detajet e delegimit të tyre në Akademi, p.sh. përmes pezullimit të përkohshëm nga detyrat e tyre gjyqësore/prokuroriale për periudhën e delegimit në Akademi; që ata të mbajnë gradën dhe pagën e tyre; mandej duhet përcaktuar se cili institucion do të paguajë pagën e tyre për periudhën e emërimit - Këshillat apo Akademia (ka argumente të forta në favor të opsionit të parë dhe shqetësime për të dytën); si bëhet vlerësimi i trajnerëve të përhershëm, nga kush dhe me cilat kritere (një opsion i besueshëm është që të vlerësohen nga Këshilli Drejtues i Akademisë, bazuar në përvojën e vendeve të rajonit), etj. Pra, të gjitha këto çështje kërkojnë qartësim përmes dispozitave të caktuara në ligjet përkatëse.

## 5. Trajnimi Fillestar

Trajnimi fillestar është trajnim i obligueshëm për gjyqtarët dhe prokurorët e sapo emëruar dhe si i tillë është paraparë me legjislacionin përkatës.<sup>27</sup> Trajnimi zgjatë 12 muaj dhe zhvillohet nga Akademia e Drejtësisë. Trajnimi përbëhet nga pjesa teorike dhe

---

<sup>27</sup> Shih Nenin 31 të Ligjit për Gjykatat (Ligji Nr. 06/L-054), Neni 8 i Ligjit Nr. 05/L-034 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit dhe Nenin 19 të Ligjit Nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë

praktike, e para të kryhet nga trajnerët dhe e dyta nga mentorët. Në bazë të ligjit<sup>28</sup>, pas përfundimit të trajnimit fillestar, gjyqtarët dhe prokurorët i nënshtrohen një vlerësimi dhe në rast të performancës jo të kënaqshme, me kërkesë të posaçme të KGJK-së dhe KPK-së, Akademia duhet të organizojë trajnim shtesë.

Megjithatë, deri më sot nuk është evidentuar asnjë rast i performancës jo të kënaqshme të gjyqtarëve në trajnimin fillestar dhe ka qenë vetëm një rast i një prokurori kur KPK i ka kërkuar Akademisë të ofrojë tri trajnime shtesë për një prokurorë pa e zbuluar emrin. Ishte arritur marrëveshje që përmes njoftimit nga KPK-ja, kur të organizohen trajnimet e caktuara në Akademi, prokurori përkatës do të aplikonte vullnetarisht. Meqenëse nuk i ishte zbuluar Akademisë, ata nuk ishin në gjendje të përgatisin raport përfundimtar për prokurorin që kishte vijuar trajnim shtesë<sup>29</sup>.

Programi i trajnimit hartohet nga Akademia në bashkëpunim dhe bashkërendim me KGJK, KPK, Gjykatën Supreme dhe Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit<sup>30</sup>. Përmbajtja e programit trajnues aprovohet nga Këshilli Drejtues i Akademisë sipas kohëzgjatjes së përcaktuar nga legjislacioni në fuqi<sup>31</sup>.

Programi për trajnimin fillestar për gjyqtarët e sapo emëruar (2017/2018) është i qasshëm në internet<sup>32</sup> i aprovuar nga Këshilli Drejtues më 6 shkurt 2017. Meqenëse programi trajnues është i kombinuar, trajnimet teorike zhvillohen dy ditë në javë përmes moduleve të trajnimit të hartuara nga trajnerët, ndërsa trajnimet praktike zhvillohen tri ditë në javë në gjykata dhe prokurori themelore, ku ata janë emëruar, me mbështetjen e gjyqtarëve/prokurorëve të shtetit-mentorë. **Programi i trajnimit fillestar është i njëjtë për të gjithë kandidatët për gjyqtar dhe prokuror dhe si i tillë ai nuk merr parasysh dallimet në përvojë të profesionistëve ligjor.** KKGJE rekomandon trajnimin fillestar të obligueshëm përmes programeve të përshtatshme për përvojën profesionale të të emëruarit<sup>33</sup>.

---

<sup>28</sup> Ibid 1

<sup>29</sup> [https://ad.rks-gov.net/Uploads/Documents/Rregullorja032017En\\_.pdf](https://ad.rks-gov.net/Uploads/Documents/Rregullorja032017En_.pdf) neni 12 par.3 i Rregullores Nr. 03/2017 për trajnimin fillestar

<sup>30</sup> Ibid, Neni 5 par.3

<sup>31</sup> Ibid Neni 5 par 1.

<sup>32</sup> [https://ad.rks-gov.net/Uploads/Documents/PTF240817Sq\\_.pdf](https://ad.rks-gov.net/Uploads/Documents/PTF240817Sq_.pdf)

<sup>33</sup> Shih CCJE (2003) Opinioni Nr.4 për trajnimin e duhur fillestar dhe gjatë shërbimit për gjyqtarë në nivel kombëtar dhe evropian, par. 26

Varësisht nga politikat dhe vizioni i hisedarëve kryesor, do të mund të merrej në konsideratë përgatitja e trajnimit fillestar në bazë të përvojës profesionale të të emëruarit meqenëse kjo do të inkurajonte më shumë profesionistë-të mesëm për të aplikuar për gjyqtar dhe prokuror, duke përfshirë këtu strategjinë afatgjatë, krijimin e profileve të kompetencave, vendosja e objektivave kyç të trajnimit fillestar, etj.

Gjithashtu, rekomandohet fuqishëm të shikohet mundësia për riorganizimin konceptual dhe institucional të trajnimit fillestar dhe procesit të rekrutimit. Do të ishte kontribut domethënës në sundimin e ligjit në përgjithësi po qe se segmentet e rekrutimit, trajnimit dhe ngritjes në detyrë të shpërndaheshin në institucione të ndryshme për të "*shmangur përqendrimin e tepërt të pushtetit në një organ gjyqësor.*"<sup>34</sup> Në këtë aspekt, do të ishte praktike të shikohej më me kujdes modeli francez dhe ai shqiptar, posaçërisht për faktin se trajnimi fillestar ka humbur rëndësinë e tij meqenëse gjyqtarët që kalojnë nëpër këtë trajnim e konsiderojnë veten të aftësuar plotësisht dhe, rrjedhimisht, nuk kanë nevojë për trajnim. Duke ia shtuar kësaj edhe faktin se deri më sot asnjë gjyqtar apo prokuror nuk e ka përsëritur trajnimin fillestar, kjo tregon se ndoshta e tërë pjesa e rekrutimit dhe trajnimit fillestar duhet të rishikohet.

Është më së e dukshme, se modeli i Trajnimit Fillestar është ndër çështjet më kritike për Akademinë dhe gjithë sistemin e Drejtësisë. Pra siç u cek, aktualisht gjyqtarët dhe prokurorët ndjekin trajnimin fillestar vetëm pasi janë emëruar në pozitat e tyre. Gjithashtu gjatë trajnimit mund të iu caktohen gjyqtarëve edhe lende për t'i shqyrtuar, nën mbikëqyrjen e mentorëve. Ky model kritikohet gjerësisht për shkak të shkoputjes së plotë ndërmjet vetë emërimit dhe trajnimit fillestar që e redukton këtë të fundit, pra trajnimin në vetëm një formalitet.

Modeli i mirëvendosur në Evropë është se Trajnimi Fillestar është pjesë e procesit të përzgjedhjes dhe gjyqtarët dhe prokurorët e rinj emërohen vetëm pas përfundimit me

---

<sup>34</sup> Rekomandimi Kyiv ..., pika 2, përcakton që:

Këshillat Gjyqësore janë organe që u janë besuar detyra të caktuara të administrimit gjyqësor dhe kompetenca të pavarura për të garantuar pavarësinë e gjyqësorit. Në mënyrë që të shmangët përqendrimi i tepërt i pushtetit në vetëm një organ gjyqësor dhe perceptimi i korporatizimit, rekomandohet që të bëhet dallimi ndërmjet dhe të ndahen kompetencat e veçanta, siç është përzgjedhja (shih paragrafët 3-4, 8), ngritja në detyrë dhe trajnimi i gjyqtarëve, disiplina (shih paragrafët 5, 9, 14, 25-26), vlerësimi profesional (shih paragrafët 27-28) dhe buxheti (shih par. 6). Një mundësi e mirë është të themelohet organe të ndryshme të pavarura që do të ishin kompetente për aspekte të caktuara të administrimit gjyqësor pa i nënshtruar ato kontrollit të një instituti apo autoriteti të vetëm. Përbërja e këtyre organeve duhet të pasqyrojnë detyrën e tyre të caktuar. Puna e tyre duhet të rregullohet me ligje statutare e jo me dekrete ekzekutiv.

sukses të Trajnimit Fillestar dhe bazuar në rezultatet e tij. Ky model rrit ndjeshëm motivimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinj për trajnim dhe gatishmërinë e tyre për profesionin, si dhe efikasitetin e trajnimit fillestar.

Dy opsione janë sugjeruar për këtë çështje:

*a. Opsioni i parë*

Të modifikohet modeli aktual, ku gjyqtarët dhe prokurorët ndjekin Trajnimin Fillestar pas emërimit; megjithatë gjatë periudhës së trajnimit ata nuk do të gjykojnë çështjet. Gjithashtu, dështimi për të përfunduar me sukses Trajnimin Fillestar do të çojë në shkarkimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Kjo qasje nuk është në kundërshtim me Kushtetutën pasi gjyqtarët dhe prokurorët mund të shkarkohen nga detyra “*për neglizhencë të rëndë të detyrave*” (neni 104.4, përkatësisht neni 109.6) dhe në pritje të trajnimit fillestar e vetmja detyrë e tyre është ta ndjekin dhe ta përfundojnë me sukses atë.

**Në këtë rast ndryshimet e nevojshme legislative do të kufizohen në:**

**1. Ligji për AD-në (Ligji për Akademinë e Drejtësisë)**

- Neni 19, shtesë në paragrafin 4:

Gjatë periudhës së trajnimit fillestar, gjyqtarët dhe prokurorët nuk do të gjykojnë. Gjatë periudhës praktike ata mund të caktohen në raste nën mbikëqyrjen e mentorëve vetëm për qëllime trajnimi.

- Neni 19, shtesa në paragrafin 2:

“Emërimi (mandati) i gjyqtarëve dhe prokurorëve që nuk e përfundojnë me sukses Trajnimin Fillestar do të ndërpritet”.

**2. Ligji për Gjykatat**

- Neni 34, paragrafi i ri 1.6: “mospërfundimi me sukses i Trajnimit Fillestar në Akademinë e Drejtësisë.

**3. Ligji për Prokurorin e Shtetit**

*b. Opsioni i dytë*

Të ndryshohet modeli sipas praktikës së përbashkët europiane në kuptimin që kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë që kalojnë me sukses provimet e përzgjedhjes, ndjekin Trajnimin Fillestar dhe emërohen vetëm pas përfundimit me sukses të tij dhe në bazë të rezultateve të tij.



**Megjithatë, do të kërkojë ndryshime legislative më thelbësore dhe në shkallë të gjerë, duke përfshirë shpërndarjen e qartë legislative të roleve në të gjithë procesin e “planifikimit - përzgjedhjes - trajnimit - vlerësimit - emërimit” ndërmjet**

- KGJK-ja dhe KPK-ja nga njëra anë, të cilët janë përgjegjës për planifikimin, përzgjedhjen fillestare dhe emërimin përfundimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, dhe
- Akademia në anën tjetër, e cila është përgjegjëse për trajnimin, vlerësimin e vazhdueshëm dhe përfundimtar të trajnuarëve.

Opsioni më i besueshëm në përputhje me kornizën aktuale kushtetuese dhe legislative është që Trajnimi Fillestar të bëhet pas përfundimit të procesit të përzgjedhjes të kryer nga KGJK-ja dhe KPK-ja, por para se kandidatët të propozohen nga Këshillat për emërim nga Presidenti. Në këtë rast, përfundimi me sukses i Trajnimit Fillestar në Akademinë e Drejtësisë është një nga kushtet që duhet plotësuar për t'u emëruar si gjyqtar apo prokuror.

Në këtë aspekt, do të ishte e nevojshme të ndryshohej:

- Ligji për Prokurorin e Shtetit – neni 19, paragrafi i ri 1.9: “Të kenë kryer me sukses Trajnimin Fillestar në Akademinë e Drejtësisë pasi të jenë përzgjedhur për këtë nga KPK-ja” (në bazë të nenit 7, paragrafi 1.7 Ligji për KPK-në – provimi për kandidatët për prokurorë) .
- Ligji për Gjykatat – Neni 30, paragrafi i ri 1.8: “Të ketë përfunduar me sukses Trajnimin Fillestar në Akademinë e Drejtësisë pas përzgjedhjes për këtë nga KGJK.
- Ligji për AD-në – Neni 19, paragrafi 1: “Akademia organizon trajnimin fillestar të kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë të shtetit, të cilët kanë dhënë provimin e organizuar nga KGJK dhe KPK. Gjyqtarë dhe prokurorë mund të emërohen vetëm kandidatët që kanë mbaruar me sukses trajnimin fillestar në Akademi” .

Nëse zgjidhet ky opsion, atëherë duhet të përpunohen rregulla të detajuara për statusin e kandidatëve (për gjyqtarë dhe prokurorë), duke përfshirë edhe shpërblimin e tyre (pagë, bursë), pushimet dhe mungesat (të rregullta, për arsye mjekësore, lehonja, etj.):

- **Emri/titulli:**  
Në vende të ndryshme evropiane, gjyqtarëve dhe prokurorëve të ardhshëm që ndjekin Trajnimin Fillestar, u jepen emra të ndryshëm: kandidatë për gjyqtarë, gjyqtarë/prokurorë praktikantë, dëgjues gjyqësor (“auditeurs de justice”) (, etj. Bazuar në traditën dhe legjislacionin e Kosovës në fuqi mund të jetë me vend që të vazhdojnë t'i quajmë "gjyqtarë kandidatë" dhe "prokurorë kandidatë".
- **Rimbursim**

Aktualisht gjyqtarët dhe prokurorët në trajnimin fillestar marrin pagat e tyre të rregullta pasi të jenë emëruar. Kandidatët do të marrin gjithashtu një shpërblim që është më i përshtatshëm për të quajtur "pagë" ose "bursë". Masa e këtij shpërblimi në vendet europiane ku ekziston modeli është rreth 70% e pagës bazë të një gjyqtari apo prokurori.

Paga do të paguhet përkatësisht nga KGJK-ja dhe KPK-ja, pasi që ato janë institucionet përgjegjëse për shqyrtimin, përzgjedhjen dhe propozimet për emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinj, përkatësisht ata paguajnë pagat e gjyqtarëve dhe prokurorëve të emëruar.

Ligji për AD-në - neni 19, paragrafi 2, ndryshohet si më poshtë: "Gjatë periudhës së trajnimit fillestar dhe në rast të përfundimit të suksesshëm të tij, deri në emërimin e tyre, kandidatët do të marrin një pagë (bursë) në shumën prej 70% nga paga bazë e gjyqtarit apo prokurorit, e paguar përkatësisht nga KGJK-ja dhe KPK-ja".

#### ➤ **Përgjegjësia disiplinore**

Aktualisht gjyqtarët dhe prokurorët në Trajnimin Fillestar i nënshtrohen rregullave të përbashkëta të përgjegjësisë disiplinore pasi të jenë emëruar. Nëse Trajnimi Fillestar do të ndodhë para emërimit, rregullat disiplinore për kandidatët do të vendosen në mënyrë eksplicite.

Ndoshta mënyra më e lehtë për ta bërë këtë do të ishte t'i referoheshit Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, aty ku zbatohet për kandidatët. Me këtë kandidatët do të duhet të ndjekin rregullat e sjelljes të vendosura për gjyqtarët dhe prokurorët dhe do të qëndrojnë nën autoritetin e të dy Këshillave.

Ligji për AD-në - neni 19, paragrafi 3, ndryshohet si vijon: "Ligji për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve do të zbatohet mutatis mutandis për kandidatët për periudhën e trajnimit fillestar dhe deri në emërimin e tyre.

Një opsion tjetër do të ishte krijimi i rregullave të veçanta disiplinore për kandidatët në Ligjin për AD-në, duke përfshirë shkeljet disiplinore, sanksionet disiplinore, organin disiplinor dhe procedurën disiplinore.

#### ➤ **Pushimi**

Aktualisht gjyqtarët dhe prokurorët në Trajnimin Fillestar i nënshtrohen rregullave të përbashkëta në lidhje me pushimin (i rregullt, në rast sëmundje, i lehonisë, apo arsye personale, etj.) pasi të jenë emëruar. Nëse trajnimi fillestar do të ndodhë përpara emërimit, rregullat në lidhje me pushimin e kandidatëve do të vendosen në mënyrë të qartë.

Një mënyrë e mundshme do të jetë referimi në rregullat për gjyqtarët dhe prokurorët, por me ndryshimin se kompetent për autorizimin e pushimit është Drejtori i Akademisë.

Opsion tjetër do të ishte krijimi i rregullave të veçanta për pushimin e kandidatëve në Ligjin për AD-në.

➤ **Ndërprerja e trajnimit**

Aktualisht, ndërprerja e trajnimit fillestar nuk ka ndikim në karrierën e gjyqtarëve dhe prokurorëve pasi të jenë emëruar. Nëse trajnimi fillestar do të ndodhë para emërimit, është e rëndësishme të rregullohet se çfarë ndodh në rast të ndërprerjes së studimeve pasi kjo sigurisht që do të ndikojë në diplomimin, pra në emërimin e kandidatëve.

Është e nevojshme të bëhet dallimi ndërmjet ndërprerjes së shkurtër dhe të gjatë të trajnimit dhe të përcaktohen siç duhet. Një ndërprerje e shkurtër mund të konsiderohet për shembull çdo periudhë më e shkurtër se një muaj në total. Një periudhë më e gjatë se një muaj mund të konsiderohet si një ndërprerje e gjatë.

Zgjidhja e natyrshme duket se në rast ndërprerjeje të shkurtër kandidati do të kompensojë pjesën e humbur të kursit sipas një plani individual, të miratuar nga Drejtori (ose Bordi). Në rast të ndërprerjes më të gjatë për arsye të justifikuara (sëmundje, shtatzëni, maternitet, etj.) zgjidhja e natyrshme duket se kandidati i jepet mundësia të përfundojë studimet me gjeneratën e ardhshme të kandidatëve në Trajnimin Fillestar. Rekomandohet që ky parim të vendoset në Ligj dhe detajet t'i lihen Rregullores për Trajnimin Fillestar. Vendimi në këtë rast mund të merret nga Bordi i Akademisë.

➤ **Vettingu (kontrolli i integritetit dhe pasurisë, konflikti i interesit)**

Kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë do të përfshihen edhe në listën e zyrtarëve që i nënshtrohen vettingut ose kontrollit të integritetit dhe pasurisë, konfliktit të interesit.

Në të dyja rastet kohëzgjatja e Trajnimit Fillestar është e arsyeshme të mbetet 12 muaj siç është tani pasi nuk ka nevojë të ndryshohet praktika e vendosur. Detajet e organizimit të pjesëve teorike dhe praktike mund të rregullohen me Rregulloren e AD-së për trajnimin fillestar, siç është rasti tani.

Natyrisht, në të dyja rastet duhet të vendosen mekanizma dhe procedura të besueshme për vlerësim dhe ekzaminim objektiv gjatë dhe në fund të Trajnimit Fillestar. Praktika evropiane tregon se qasja më e mirë në këtë drejtim është të kesh një mori burimesh të pavarura vlerësimi. Ndryshimet eventuale në lidhje me vlerësimin për pjesën teorike dhe praktike të trajnimit fillestar mund të bëhen përmes Rregullores së AD-së për trajnimin fillestar, siç është rasti tani.

Në të dyja rastet, KGJK-ja dhe KPK-ja duhet të bëjnë një planifikim të kujdesshëm të vendeve të lira të punës dhe të nevojave për gjyqtarë dhe prokurorë të rinj, së paku një/një vit e gjysmë përpara. Procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit do të ridizajnohen në mënyrë që të merret parasysh koha e nevojshme për të planifikuar, përgatitur dhe kryer Trajnimin Fillestar.

Për ta përmbledhur, opsioni i parë është më i lehtë për t'u zbatuar, kërkon ndryshime minimale legislative dhe mund të zbatohet në një kohë relativisht të shkurtër, gjë që është e rëndësishme nga pikëpamja politike, duke përfshirë në aspektin e Strategjisë së RoL dhe raportit të progresit të BE-së..

Opsioni i dytë kërkon ndryshime më të detajuara legislative, si në Ligjin për AD-në ashtu edhe në ligjet tjera të ndërlidhura (Ligjin për Gjykatat, Ligjin për Prokurorinë e Shtetit, Ligjin për KGJK-në, Ligjin për KPK-në, Ligji për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve) që nga statusi krejtësisht i ri. për kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë duhet të vendosen.

Ndoshta një zgjidhje e ekuilibruar është të fillojmë reformën me opsionin e parë, ndërkohë që përgatitemi me kujdes për opsionin e dytë si një objektiv afatgjatë.

## **7. Mosekzistim i trajnimeve të specializuara**

Opinionin 4 i KKGJE diskuton gjerësisht avantazhet dhe disavantazhet e mundshme të specializimit të gjyqtarëve dhe ua lë vendeve anëtare ta mbështesin apo jo specializimin e mëtutjeshëm të gjyqtarëve. Konkluzionet e tij janë se në parim, roli mbizotërues shqyrtimin gjyqësor duhet të ndërmerret nga gjyqtarët e 'përgjithshëm', ndërsa gjyqtarët dhe gjykatat e specializuara duhet të aplikohen vetëm kur është e nevojshme për shkak të ndërlikueshmërisë apo veçantisë së ligjit apo fakteve dhe, rrjedhimisht, për administrimin e duhur të drejtësisë.

Struktura e gjykatave të Kosovës është 'centralizuar' pas luftës së vitit 1999. Përderisa para luftës ishin gjykata të përgjithshme të ashtuquajtura gjykata 'të rregullta' (përgjegjëse për lëndë penale dhe civile), kishte gjithashtu edhe gjykata të veçanta të specializuara - gjykata ekonomike dhe gjykata për çështje lidhur me marrëdhënien e punës.

Sipas strukturës së re të gjykatave, ka filluar me 'gjykata të specializuara'. Rishtazi është themeluar Gjykata Komercial dhe po ashtu, në programin e Qeverisë është edhe themelimi i Gjykatës Administrative dhe asaj së Punës.

Andaj, nevoja për trajnime të mëtutjeshme në kuadër të gjykatave të specializuara dhe departamenteve është thelbësore, për shkak të natyrës së lëndëve me të cilat gjyqtarët nuk janë aq të familjarizuar, Megjithatë, specializimi i gjyqtarëve për një grup të caktuar të është një gjë që duhet shikuar me kujdes meqenëse Kosova nuk ka gjykata dhe prokurori aq të mëdha, me numër të madh të gjyqtarëve apo prokurorëve dhe numër të madh të lëndëve, për të arsyetuar specializime të posaçme.

Andaj, ndryshime duhet të bëhen që të përfshihen trajnime të specializuara në rast se arsyetohet organizimi dhe zhvillimi i tyre varësisht kërkesave dhe rrethanave të reja që krijohen. KKGJE thekson, mbi të gjitha, faktin se të gjithë gjyqtarët, qoftë ai/ajo i përgjithshëm apo i specializuar, duhet të jenë ekspertë në artin e gjykimit.

## Kapitulli 2: Objektivat

Në radhë të parë, kjo politikë hyn në kuadër të qëllimit strategjik “Përmirësimi i funksionimit të institucioneve të drejtësisë” të Planit Strategjik Operacional të Qeverisë/Ministrit të Drejtësisë 2022-25, dhe nën qëllimit “*Avancimi i legjislacionit për administratën e gjykatave, prokurorive dhe Akademinë e Drejtësisë*”, ku parashihet hartimi i Koncept Dokumentit për Akademinë e Drejtësisë. Përmes këtij dokumenti synohet adresimi i të metave nga ligji aktual në fuqi por edhe avancimi i mëtutjeshëm politikave dhe legjislacionit që prek këtë fushë.

Strategjia për Sundim të Ligjit po ashtu në kuadër të “Ngritjes e profesionalizmit dhe kompetencës së personelit gjyqësor dhe prokurorial” parasheh si masë të dytë përshtatjen e programeve të trajnimit profesional me nevojat specifike të sektorit dhe të profesionistëve specifike. Kjo do të mundësohej përmes përdorimit të të dhënave nga vlerësimet e performancës, duke identifikuar kështu mangësitë profesionale, reformimit dhe rishikimit të vazhdueshëm të kurrikulave nga Akademia e Drejtësisë, dhe bashkëpunimit të KGJK-së, KPK-së dhe Akademisë në hartimin e kurrikulave moderne.

*Figure 3: Objektivat relevante të Qeverisë*

<b>Objektivi relevant</b>	<b>Emri i dokumentit përkatës të planifikimit (burimi)</b>
<i>Qëllimi strategjik -</i> Përmirësimi i funksionimit të institucioneve të drejtësisë	Plani Strategjik Operacional i Ministrisë së Drejtësisë 2022-2025.  Strategjia për Sundim të Ligjit
<i>Objektiva specifike -</i> Qartësimi i kompetencave ndërmjet AD në njërin anë dhe KGJK/KPK në anën tjetër	Sipas këtij Koncept Dokumenti.
<i>Qëllimi i politikës -</i> Avancimi i politikave të trajnimit për gjyqtarë, prokurorë dhe kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë	Sipas këtij Koncept Dokumenti.

## **Kapitulli 3: Opsionet**

### Kapitulli 3.1: Opsioni asnjë ndryshim

Opsioni asnjë ndryshim nënkupton që nuk do të merren kurrfarë masa zbatuese dhe as legislative për të adresuar problemet kryesore të shpjeguara më lartë.

Me opsionin pa asnjë ndryshim do të vazhdonin të ekzistonin problemet kryesore lidhur me organet drejtuese, parimet e trajnimeve, respektivisht kush mund të vijojë cilat trajnime, përkufizimi i trajnimeve, çështjet e trajnuesve të përhershëm nga radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve, dhe më kryesorja trajnimin fillestar të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Ky Opsion nuk është i rekomandueshëm.

## Kapitulli 3.2: Opsioni për përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit politikave dhe legjislacionit ekzistues

Ky Opsion nuk është i rekomandueshëm pasi që nga koha kur janë bërë ndryshime në ligjet përkatëse të gjyqësorit dhe Ligjit për Akademinë e Drejtësisë, çështjet që kanë të bëjnë me vlerësimin e trajnimeve fillestarë, emërimin e trajnerëve të përhershëm, si dhe çështjet që kanë të bëjnë me nxjerrjen e akteve nën ligjore nga Këshillat përkatës, kanë rezultuar të pasuksesshme në praktikë.

Si rrjedhojë, konsiderohet që realizimi i këtij Opsioni në praktikë është vështirë i arritshëm kur kemi parasysh faktin që çështjet ndër institucionale mbi të cilat varet zbatimi me sukses i dispozitave ligjore jo rralle here ka qenë shkak për moszbatim të Ligjit duke drejtuar gishtin ndaj njeri tjetrit për dështim të zbatimit të ligjit.

Gjithashtu, pika ku kërkon trajtim kryesor ky Koncept Dokument është trajnimi fillestar, i cili nuk mund të adresohet ndryshe pa ndryshuar kornizën aktuale ligjore. Kjo vlen, sidomos sa i përket vlerësimit të trajnimit fillestar, respektivisht vlerësimi që duhet bërë nga Akademia dhe nga Këshillat përkatës. Kjo fazë delikate e zhvillimit të karrierës ka qenë dhe mbetet çështje e diskutueshme se a ka dhe sa ka vlerësim cilësor nga Këshillat rreth vijimit të trajnimit fillestar, kur dihet se trajnimi organizohet, zhvillohet dhe administrohet nga Akademia. Si rrjedhojë, çdo tentim për ta adresuar këtë problematikë vetëm nga rrafshi praktik, pa bërë ndryshime ligjore do të ishte i destinuar të dështojë.



## Kapitulli 3.3: Opsioni për ndryshimin dhe plotësimin e kornizës ekzistuese ligjore

### Plotësim / Ndryshimi i Ligji aktual për Akademinë e Drejtësisë

Opsioni i tretë, dhe i rekomanduari, është që MD-ja të iniciojë nxjerrjen e një Ligji për ndryshimin dhe plotësimin Ligjit për Akademinë e Drejtësisë. Në vijim të kësaj, më poshtë do të shtjellohen më në detaje, propozimet që ky Koncept Dokument jep në lidhje me secilën tematikë.

### STATUSI JURIDIK

Me ndryshimet e reja në Ligj për Akademinë e Drejtësisë, do të ri-afirmohet pavarësia institucionale dhe juridike e Akademisë së Drejtësisë, me lidhje të forta si në aspektin e raportimit por edhe operacionalizimit të Akademisë me Kuvendin e Kosovës, si organ themelues i Akademisë, por edhe me institucionet tjera ndaj të cilave Akademia ofron shërbime e që janë, KGJK, KPK dhe Ministria e Drejtësisë.

Në këtë drejtim, propozohet që Akademia të përkufizohet si:

- a) institucion publik i pavarur me cilësinë e personit juridik i themeluar në bazë të nenit 142 të Kushtetutës,
- b) ka buxhetin e vet i cili administrohet në mënyrë të pavarur dhe në përputhje me ligjin për financat publike dhe legjislacionin tjetër përkatës,
- c) mbikëqyret nga një Bord Drejtues, përbërja dhe mandati i të cilit caktohet me ligj .

Një solucion i tillë do të ishte edhe në përputhshmëri me fushë veprimtarinë e Komisionit për Legjislacion Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, pasi që në kuadër të kompetencave të tij ka edhe “shqyrtimin e çështjeve të gjyqësisë në Kosovë” e që ngritja e kapaciteteve të gjyqtarëve dhe prokurorëve, siç u cek në fillim të këtij Koncept Dokumenti, përben një ndër kompetentët kryesore të sistemit gjyqësor dhe prokurorial në Kosovë.

Megjithatë, këtu duhet të kemi parasysh, siç kemi cekur më lartë në këtë Koncept Dokument, Ligji për Administratën Shtetërore dhe Agjencitë e Pavarura (neni 38) përcakton disa kritere për themelimin e agjencive të pavarura e që mandati dhe misioni i Akademisë nuk përkojnë me ato kritere. Andaj, vëmendja të veçantë duhet pasur në drejtim të këtij kolizioni të mundshëm ligjor.

Në aspekt të raportimit, Akademia e Drejtësisë do të raportojë para Komisionit për Legjislacion vetëm sa i përket çështjeve që kanë të bëjnë me ngritjen e kapaciteteve dhe çështjet e shpenzimit të buxhetit të Akademisë. Çfarëdo çështje individuale sa i përket ngritjes së kapaciteteve nuk do jetë pjesë e raportimit të Akademisë.

## **ORGANET DREJTUESE**

### **Këshilli Drejtues**

Këshilli Drejtues është organi më i rëndësishëm i Akademisë së Drejtësisë.

Përbërja dhe mandati i anëtarëve të propozuar për Këshillin Drejtues do të caktohet me ligj.

Kompetencat e Këshillit Drejtues janë:

- Zgjedhja e Këshillit Programor (përfshire edhe Përfaqësues nga Sekretariatet, të jete të nivelit me lartë profesional (drejtues), përfshirë administratorët e gjykatave
- Caktimi i Trajnuesve, Mentorëve (që rregullohet me akt të brendshëm, pas rekomandimit të Këshillit Programor)
- Zgjedhja dhe shkarkimi i drejtorit të AD
- Nxjerrja e akteve nënligjore (specifikimi i tyre me Ligj).

Ligji po ashtu duhet të parasheh edhe situatat të papajtueshmërisë, pra rastet kur anëtarët e Këshillave ose kryetarët e Gjykatave të mos jenë anëtarë të Këshillit Drejtues ose kur anëtarët e Këshillit Drejtues nuk do të mund të angazhohen si trajnues në Akademi ose në Këshill Programor.

Për më tepër, Ligji ri duhet të parasheh edhe mënyrën e përzgjedhjes së Kryetarit të Këshillit Drejtues, i cili, përveç tjerash, do të raportojë para Komisionit për Legjislacion.

Po ashtu, Ligji i ri të dispozita kalimtare duhet të parasheh situatat kur duhet lënë mundësi intervenimi të Këshillit Drejtues aktual deri në funksionimin e Këshillit të ri në mënyrë që të sigurohet kontinuiteti i veprimtarisë së Akademisë.

## Këshilli Programor

Këshilli Programor, me ndryshimet e reja të propozua do të përzgjidhet nga Këshilli Drejtues, përmes një konkursi të hapur me kritere të paracaktuara nga radhët e individëve me kredibilitet dhe shkallë të lartë të profesionalizmit.

Në parim, sugjerohet që Këshilli Programor të ketë anëtarë nga radhët e gjykatave dhe prokurorive, administrata e gjykatave dhe prokurorisë, nga radhët e akademisë (fakulteteve), etj. Sa i përket numrit të anëtarëve, propozohet që të ketë një përbërje prej jo më pak se 12 anëtarë, në mënyrë që të mundësohet një gjithë përfshirje e të gjitha strukturave që do merrnin shërbime të trajnimit nga Akademia.

Fushat nga të cilët do të mbulonin anëtarët e Këshillit Programor do të jenë ajo penale, civile, administrative, komerciale, nga shkallët e ndryshme gjykatave, si dhe fushat relevante tëra për çështjet e administratës së gjykatave dhe prokurorive.

Mandati i anëtarëve të Këshillit Programor do të jetë tre (3) vjet, pa drejtë rizgjedhjeje si dhe në të njëjtën kohë anëtarët e Këshillit Programor nuk do të mund të angazhohen si trajnues në Akademi.

Përveç kompetencave aktuale, kompetenca shtesë më të cilat do të mvishej Këshilli Programor janë edhe i) trajtimi i ankesave ndaj trajnuesve në lidhje me metodologjinë e trajnimit si dhe ii) vlerësimi i trajnuesve.

## Drejtori i Përgjithshëm i Akademisë së Drejtësisë

Një ndër ndryshimet që duhet paraparë me Ligjin e ri janë edhe kriteret për emërimin e Drejtorit. Si fillim, do duhet ndryshuar emërtimi i Drejtorit të Akademisë në Drejtor të Përgjithshëm, për të i dhënë edhe për nga emërtimi peshën e rolit dhe mandatit me të cilën është e mveshur kjo pozitë.

Për më tutje, disa nga rrishtet që duhet paraparë janë:

- Të eliminohet mundësia që në pozitën e Drejtorit të vijë dikush nga radhët e gjyqtarëve apo prokurorëve për shkak të regjimeve totalisht të ndryshme juridike me të cilat rregullohen këto dy pozita (Ligji për Zyrtarë publik kundrejt Ligjit për Gjykatat / Prokurorin e Shtetit) – pra kjo të parashihet si një ndër kriteret e papajtueshmërive,
- Një kriter shtesë për Drejtor të jetë edhe Provimi i Jurisprudencës,

- Që me Ligj të jetë i mveshur me përgjegjësitë e Zyrtarit Kryesor Administrativ, ashtu siç parashihet me Ligjin për Financa Publike,
- Mandati i Drejtorit të jetë siç parashihet me Ligjin për Zyrtarë Publikë, dhe të jetë i ngjashëm me Drejtorin e Sekretariatit të KGJK-së ose KPK-së, përfshirë këtu edhe nivelin e kompensimit,
- Në aspekt të raportimit, Drejtori i raporton Këshillit Drejtues, derisa së bashku me Kryetarin e Këshillit Drejtues i raporton Komisionit për Legjislacion.

Ligji duhet të përcaktojë që detajet tjera të emërimit dhe shkarkimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Akademisë, duhet rregulluar me akt nënligjor të miratuar nga Këshilli Drejtues.

## **LLOJET E TRAJNIMIT DHE KUSHTET E VIJIMIT TE TRAJNIMIT**

Një ndër mangësitë e ligji aktual është mos definimi i qartë i llojit të trajnimeve dhe rastet dhe kushtet që duhet përmbushur për të vijuar trajnime të caktuara.

Si rrjedhojë, Ligji i ri do duhej të ketë përkufizime të qarta në lidhje me llojet e trajnimit dhe audiencën e atyre trajnimeve.

Për këtë qëllim, Ligji i ri duhet të jap sqarime së çka nënkupton:

- Trajnimi Fillestar, dhe kush mund të jetë pjesë e atij trajnimi deri te vlerësimi përfundimtar,
- Trajnimi i Vazhdueshëm, dhe kush mund të jetë pjesë e atij trajnimi deri te vlerësimi përfundimtar,
- Trajnimi për Specializim, dhe kush mund të jetë pjesë e atij trajnimi deri te vlerësimi përfundimtar,
- Trajnimet për ngritje në detyrë, dhe kush mund të jetë pjesë e atij trajnimi deri te vlerësimi përfundimtar,
- Trajnim për emërim në një pozicion drejtues,
- Trajnim për anëtarët e organeve drejtuese të sistemit të drejtësisë, dhe
- Trajnime për personelin administrativ.

Për më tepër, Ligji do duhej të jep edhe parametra të qarta në lidhje me rastet dhe kushtet për trajnim të detyrueshëm, si dhe vlerësimin nga ky trajnimi i detyrueshëm.

Po ashtu, trajnuesit qe vijnë nga radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve në të ardhmen do të paguhen vetëm për përgatitjen e moduleve dhe materialit trajnues dhe jo edhe për shërbimin e dhënies se trajnimit.

## **TRAJNUESIT E PËRHERSHEM / MENTORET**

Një ndër mangësitë funksionale të Akademisë, siç është evidentuar edhe me këtë Koncept Dokument, është mungesa e Trajnuesve të Përhershëm nga radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Në këtë drejtim, Ligji i ri duhet të përcaktoj që së paku 4 gjyqtarë dhe 2 prokurorë të delegohen nga Këshillat përkatës, për të shërbyer si Trajnues të Përhershëm në Akademinë e Drejtësisë e të cilët do të mbulonin modulet tipike në çështjet penale, civile, administrative dhe komerciale.

Trajnuesit e Përhershëm do të emërohen nga radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve që i) kanë vlerësim të shkëlqyeshëm ose shumë të mirë të performancës, si dhe te ii) kenë vlerësim të mirë në Akademi si trajnues.

Periudha e delegimit duhet të jetë dy (2) vjeçare pa mundësi vazhdimi, dhe gjate kësaj periudhe gjyqtari apo prokurori do duhej liruar nga realizimi i normës dhe vlerësimi i performancës. Vlerësimi i rregullt (tre vjeçar) i performancës si gjyqtar apo prokuror do duhet bere vetëm për vitin e mbetur para ose pas periudhës si trajnues i përhershëm.

Për më tepër, Akademia do të angazhojë nga radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve me mandat të përhershëm, përmes konkursit të hapur, edhe mentorë për të mentoruar vijuesit e trajnimit fillestar, të cilët do të bëjnë edhe vlerësimin - për qëllim të Akademisë se Drejtësisë - të kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë.

Çështjet qe duhet shtjelluar tutje përmes normave ligjore për trajnuesit e përhershëm ne raport me funksionin e tyre primar janë: Vlerësimi i punës, Pagesa, Disiplinimi, pezullimi i detyrës, etj.

## **TRAJNIMI FILLESTAR**

Ligji i ri duhet të përcaktojë një model të ri të trajnimit fillestar, pasi që modeli aktual është treguar si jo i përshtatshëm për kontekstin vendor, për arsyt si në vijim:

- ka rënie drastike të seriozitetit të trajnimit pas dekretimit, pasi që gjyqtarët po e konsiderojnë vetën si të plotësuar në aspektin profesional dhe nuk kanë nevojë për trajnime shtesë,

- për shkak se nuk ka një bashkërendim as ligjor as ndërinstitucional sa i përket vlerësimit të kandidatëve,
- për shkak se mandati fillestar prej tre viteve, i paraparë me Kushtetutë, kërkon vlerësim të performancës së gjyqtarit/prokuratorit në kryejë të lëndëve (e jo në trajnim),
- dhe është model që nuk e gjejmë në shumicën e shteteve evropiane.

Si rrjedhojë, Ligji i ri do të parasheh që trajnimi fillestar në Akademi do të zhvillohet para së të bëhet dekretimi te Presidenti. Një rrjedhë kronologjike e procesit, është ilustruar si në vijim:

1. KGJK/KPK bëjnë planifikimin e vendeve të lira kohë më parë dhe njoftojnë Akademinë parapakëshit mbi nevojat e trajnimit me qëllim që të i lihet hapësirë për organizmin e duhur të trajnimit.
2. KGJK/KPK bëjnë shpalljen e vendeve të lira për gjyqtarë/prokuratorë sipas nenit 108, respektivisht 110 të Kushtetues së Republikës së Kosovës dhe pas provimit pranues njofton Akademinë për kandidatët e suksesshëm.
3. Kandidatët e suksesshëm për gjyqtarë/prokuratorë fillojnë trajnim fillestar në Akademi të Drejtësisë, dhe
4. vetëm pas përfundimit dhe vlerësimi të suksesshëm nga ana e Akademisë së Drejtësisë, KGJK/KPK dërgohen për dekretim.

Siç edhe u cek më lartë, avantazhi i këtij modeli është motivimi më i lartë për të mësuar, efikasiteti më i lartë i trajnimit dhe përgatitja më e lartë e gjyqtarëve dhe prokuratorëve të ardhshëm për profesionet e tyre pasi në këtë rast procesi i përzgjedhjes përfshin jo vetëm provimet pranuese, por edhe performancën gjatë trajnimit dhe në provimet finale.

Megjithatë, ky model kërkon që të ketë ndryshim ligjore edhe në Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Ligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës, pasi që këto dy organe janë kompetente për përzgjedhjen fillestare dhe emërimin përfundimtar të gjyqtarëve dhe prokuratorëve, dhe Akademia nga ana tjetër, e cila është përgjegjëse për trajnimin fillestar dhe vlerësimin e vazhdueshëm të të trajnuarve.

Po ashtu me Ligj duhet paraparë edhe një dispozitë ligjore që, përveç shkeljeve serioze, kandidatët për gjyqtarë dhe prokuratorë të cilët kalojnë suksesshëm trajnimin fillestar u garantohet emërimi përfundimtar. Kjo dispozitë garantuese rezulton të jetë e domosdoshme pasi që pa një dispozitë të tillë ka drojë së kandidatët nuk do të i braktisin punët e tyre aktuale për të i hyrë një rrugëtimi për t'u bërë gjyqtar dhe prokurator nëse nuk kanë një garancë të tillë, e që edhe një herë, është vetëm garancë ligjore **për ato çështje që janë jashtë kontrollit të kandidatëve për gjyqtarë dhe prokuratorë.**

Për më tepër, me Ligj duhet të përpunohen gjithashtu edhe rregulla të detajuara për shpërblimin e tyre (pagë, bursë), pushimet dhe mungesat (të rregullta, për arsye mjekësore, lehonja, etj.), përgjegjësia disiplinore dhe procedurat, etj.

Trajnimi fillestar do të zgjasë 12 muaj, dhe pjesa qenësore e trajnimit do të përqendrohet në të pajisurin e kandidatit për gjyqtar dhe prokuror më të njëjta njohuri ashtu që në ditën e parë të punës si gjyqtar dhe prokuror të jetë në gjendje të debatojë në aspektin profesional me kolegët e tjerë gjyqtarë dhe prokurorë që kanë përvojë më shumë në sistem. Një qasje e tillë, kërkon që trajnimi fillestar, sidomos në pjesën e dytë të jetë i përqendruar shumë më shumë në praktikën gjyqësore dhe në trajtimin e lëndëve që paraqesin dilemë profesionale ndërmjet shkallëve të ndryshme gjyqësore.

Natyrisht se kjo pjesë e fundit është me shume përshkruese e qëllimit të Trajnimit Fillestar, por që përmes Ligjit do të duhet të vendosej një dispozitë që tregon qëllimin e trajnimit fillestar dhe përmes asaj dispozite të vendosen kërkesat ndaj Akademisë së Drejtësisë mbi atë se si do të duhej të duken modulet dhe kurrikulimi për Trajnimin Fillestar.

Ligji i ri duhet të parasheh rregulla të detajuara për statusin e kandidatëve (për gjyqtarë dhe prokurorë), duke përfshirë edhe shpërblimin e tyre (pagë, bursë), pushimet dhe mungesat (të rregullta, për arsye mjekësore, lehonja, etj.), çështjet disiplinore, etj.

Në të dyja rastet kohëzgjatja e Trajnimit Fillestar është e arsyeshme të mbetet 12 muaj siç është tani pasi nuk ka nevojë të ndryshohet praktika e vendosur. Detajet e organizimit të pjesëve teorike dhe praktike mund të rregullohen me Rregulloren e AD-së për trajnimin fillestar, siç është rasti tani.

Ky opsioni i rekomanduar kërkon ndryshime më të detajuara legjislative, si në Ligjin për AD-në ashtu edhe në ligjet tjera të ndërlidhura (Ligjin për Gjykatat, Ligjin për Prokurorinë e Shtetit, Ligjin për KGJK-në, Ligjin për KPK-në, Ligji për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve) në mënyrë që statusi i ri për kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë të rregullohet me detaje.

## Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme

Në kuadër të këtij kapitulli paraqiten ndikimet më të rëndësishme që janë identifikuar lidhur me opsionet e analizuar në këtë Koncept Dokument.

Ndërkaq, shtojcat 1 deri 4 paraqesin vlerësimin e të gjitha ndikimeve në përputhje me mjetet për identifikimin e ndikimeve ekonomike, shoqërore, mjedisore dhe ndikimeve të të drejtave themelore. Këto mjete janë të listuara në Manualin për Hartimin e Koncept Dokumenteve. Katër shtojcat gjithashtu tregojnë vlerësimin e rëndësisë së ndikimeve të ndryshme dhe nivelin e preferuar të analizës.

Në tabelën e mëposhtme listohen ndikimet më të rëndësishme të identifikuara të opsionit të parë.

Figura 7: Ndikimet më të rëndësishme të identifikuara për kategorinë e ndikimit për opsionin 1

Kategoritë e ndikimeve	Ndikimet përkatëse të identifikuara
	Opsioni 1 dhe 2
Ndikimet ekonomike	Nuk ka ndikime të drejtpërdrejta
Ndikimet shoqërore	Nuk ka ndikime të drejtpërdrejta
Ndikimet mjedisore	Nuk ka ndikime të drejtpërdrejta
Ndikimet në të drejtat themelore	Nuk ka ndikime të drejtpërdrejta
Ndikimi gjinor	Nuk ka ndikime të drejtpërdrejta.
Ndikimet e barazisë sociale	Nuk ka ndikime të drejtpërdrejta.
Ndikimet tek të rinjtë	Nuk ka ndikime të drejtpërdrejta.
Ndikimet në ngarkesën administrative	Nuk ka ndikime të drejtpërdrejta.



Ndikimi i NMV-ve	Nuk ka ndikime të drejtpërdrejta.
------------------	-----------------------------------

Kategoritë e ndikimeve	Ndikimet përkatëse të identifikuara
	Opsioni 3
Ndikimet ekonomike	Nuk ka ndikime të drejtpërdrejta
Ndikimet shoqërore	Nuk ka ndikime të drejtpërdrejta
Ndikimet mjedisore	Nuk ka ndikime të drejtpërdrejta
Ndikimet në të drejtat themelore	Nuk ka ndikime të drejtpërdrejta
Ndikimi gjinor	Nuk ka ndikime të drejtpërdrejta.
Ndikimet e barazisë sociale	Nuk ka ndikime të drejtpërdrejta.
Ndikimet tek të rinjtë	Nuk ka ndikime të drejtpërdrejta.
Ndikimet në ngarkesën administrative	Nuk ka ndikime të drejtpërdrejta.
Ndikimi i NMV-ve	Nuk ka ndikime të drejtpërdrejta.

Ndikimet më të rëndësishme që mund të shfaqen nëse vendoset, për adresimin e problemit të evidentuar në këtë Koncept Dokument, përmes ndryshimeve ligjore do të trajtohen në kuadër të tabelës vijuese. Ky elaborim do vlejë njëkohësisht për opsionin 2 dhe 3.

#### Kapitulli 4.1: Sfidat me mbledhjen e të dhënave

Gjatë hartimit të Koncept Dokumentit nuk janë paraqitur sfida të theksuara në mbledhjen e të dhënave. Në këtë drejtim, informatat e nevojshme për zhvillimin e analizës dhe hartimin e këtij Koncept Dokumenti janë siguruar përmes takimeve të drejtpërdrejta me akterët relevantë.

## Kapitulli 5: Komunikimi dhe konsultimi

Në këtë kapitull është paraqitur plani i aktiviteteve të komunikimit dhe konsultimit për këtë Koncept Dokument. Pjesa më e madhe, e palëve të brendshme të interesuara (ato të paraqitura në Figurën 4 nga Kapitulli mbi Përkufizimin e Problemit), janë pjesë e grupit punues dhe kanë hartuar apo janë konsultuar gjatë hartimit të dokumentit. Sa i përket publikut, gjithashtu janë planifikuar aktivitete në këtë drejtim, të përcaktuara në tabelën e mëposhtme, në mënyrë që kjo politikë, e cila është e natyrës së re në Kosovë, të komunikohet dhe konsultohet në mënyrë të duhur deri në finalizimin e saj.

Konsultimi paraprak sipas Rregullores së Punës së Qeverisë do të realizohet pas përfundimit të punës së grupit punës në draftin fillestar. Gjithashtu, bazuar edhe në Rregulloren për standardet minimale për konsultime me publikun do të realizohet konsultimi publik edhe përmes platformës online për konsultimet publike.

*Figura 9: Përmbledhje e aktiviteteve të komunikimit dhe konsultimit të kryera për një koncept dokument*

Procesi i konsultimit synon:						
- Marrjen e opinionit nga palët e interesuara lidhur me politikën e re në aspekt të përgjithshëm, si dhe me masat specifike dhe elementet tjera të saj në veçanti (për më shumë shihni Kapitullin 3 të këtij Dokumenti – Opsionet).						
Qëllimi kryesor	Grupi i synuar	Aktiviteti	Komunikimi/njoftimi	Afati indikativ	Buxheti i nevojshëm	Personi përgjegjës
Konsultimi i institucioneve relevante						
Takimi i hapur për të gjithë palët e interesuara						
Konsultimi i palëve të jashtme të interesuara						
Konsultimi i palëve të						

jashtme të interesuara						
---------------------------	--	--	--	--	--	--

## Kapitulli 6: Krahasimi i opsioneve

Për adresimin e problemit të parashtruar në këtë Koncept Dokument, tre opsione janë marrë në konsideratë: opsioni pa asnjë ndryshim, opsioni për përmirësimin e zbatimit të Ligjeve në praktikë, dhe opsioni për miratimin e një ligji të veçantë për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Akademinë e Drejtësisë.

Megjenëse të tre këto opsione janë trajtuar hollësisht në kapitullin 3, kjo pjesë e Koncept Dokumentit do të fokusohet shkurtimisht në krahasimin e tyre duke marrë për bazë përparësitë dhe disavantazhet e tyre dhe duke u mbështetur në analizën shumë kriterëshe.

Opsioni 1 i cili nuk propozon ndërmarrjen e ndonjë ndryshimi, por në vend të kësaj parasheh ruajtjen e *status quo*, nuk ngërthen në vete ndonjë përfitim.

Opsioni 2, po ashtu është vështirë i realizueshëm pasi që pavarësisht tentativave të kaluar, edhe me ndihmën e partnerëve ndërkombëtarë nuk kanë rezultuar me sukses në ngritjen e efikasitetit dhe zbatimit të mirëfillt të ligjit për Akademinë e Drejtësisë, pasi që shumë kompetenca të parapara në këtë Ligj janë të shpërndara në disa organe të ndryshme si KGJK dhe KPK.

Andaj, përmirësimi i zbatimit në praktikë të këtij Ligji pa ndryshime ligjore do të jetë e destinuar që të dështojë.

Kurse, Opsioni 3 i cili është opsion i rekomanduar i Grupit Punues parasheh ndryshimet ligjore që tentojnë të adresojnë çështjet e elaboruar të identifikuar si sfida në zbatim të këtij ligji por edhe propozime të reja në avancim të politikave në funksion të zbatimit të rekomandimeve të dalura nga Strategjia për Sundim të Ligjit. .

Së këndejmi, çështjet si anëtarësia e Këshillit Drejtues dhe situata e konfliktit të interesave, trajnimi fillestar për kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë, si dhe pagesat e trajnuesve do të trajtohen në mënyre eksplicite në kuadër të ligjit të ri.

Edhe pse ne aspektin e draftimit do të jetë proces më sfidues, arsyeshmëria dhe qëllimi i amendamenteve justifikojnë një proces të tillë. Ligjet që do të preken nga ky proces legjislativ janë:

1. Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës,
2. Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës,
3. Ligji për Gjykatën Komerciale,
4. Ligji për gjykata, dhe
5. Ligji për Prokurorin e Shtetit.

## Kapitulli 6.1: Plani i zbatimit për opsionet e ndryshme

Në vazhdim është paraqitur plani i zbatimit për opsionin 3 të propozuar nga ky Koncept Dokument.

Figura 1: Plani i zbatimit për Opsionin 3

<b>Qëllimi i politikës</b>	Avancimi i politikave të trajnimit për gjyqtarë, prokurorë dhe kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë							Shifra e kostonë së pritur	
<b>Objektivi strategjik</b>	Përmirësimi i funksionimit të institucioneve të drejtësisë								
	<b>Outputi, aktivitetet, viti dhe organizata/departamenti përgjegjës</b>								
<b>Objektivi Specifik 1</b>	<b>Outputi 1.1</b>		Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Institucioni /departamenti përgjegjës	
Qartësimi i kompetencave ndërmjet AD në njërën anë dhe KGJK/KPK në anën tjetër	Ndryshimi i legjislacionit primar përkatës (pako e ligjeve) që ndërlidhen me politikat e trajnimit për gjyqtarë, prokurorë dhe kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë	Aktiviteti 1.1.1	X					MD	Nuk ka kosto shtesë
		Hartimi i Ligjit për Ndryshimin /Plotësimin e Ligjit për Akademinë e Drejtësisë							
		Aktiviteti 1.1.2	X						MD
		Hartimi i Ligjit për							

		Ndryshimin /Plotësimin e Ligjit për Gjykata							
		Aktiviteti 1.1.3 Hartimi i Ligjit për Ndryshimin /Plotësimin e Ligjit për Prokurorin e Shtetit	X					MD	Nuk ka kosto shtesë
		Aktiviteti 1.1.4 Hartimi i Ligjit për Ndryshimin /Plotësimin e Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës	X					MD	Nuk ka kosto shtesë
		Aktiviteti 1.1.5 Hartimi i Ligjit për Ndryshimin /Plotësimin e Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës	X					MD	Nuk ka kosto shtesë

## **Kapitulli 7: Konkluzionet dhe hapat e ardhshëm**

Në bazë të këtyre që u theksuan më lartë, grupi punues është i mendimit që Opsioni 3 i paraqitur në këtë Kapitullin 3 të këtij Koncept Dokumenti është opsioni më i përshtatshëm nga shumë aspekte, për arritjen e objektivave të Qeverisë. Kështu që, Qeverisë së Republikës së Kosovës i propozohet miratimi i këtij Koncept Dokumenti me Opsionin 3 të rekomanduar, gjegjësisht hartimin e Ligjit të ri një për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Akademinë e Drejtësisë dhe ligjeve tjera relevante (ligji omnibus).

### **Kapitulli 7.1: Dispozitat për monitorimin dhe vlerësimin**

Zbatimi i aktiviteteve të parapara në Planin e Veprimit por edhe këtij Ligji në përgjithësi, do të monitorohen nga Ministria e Drejtësisë.

Shtojca 1: Forma e vlerësimit për ndikimin ekonomik

Kategoria e ndikimeve ekonomike	Ndikimi kryesor	A pritët të ndodhë ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur	Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit	Niveli i preferuar i analizës
		Po	Jo			
Vendet e punës <sup>35</sup>	A do të rritet numri aktual i vendeve të punës?		X			
	A do të zvogëlohet numri aktual i vendeve të punës?		X			
	A do të ndikojë në nivelin e pagesës?		X			
	A do të ndikojë në lehtësimin e gjetjes së një vendi të punës?		X			
Bërja e biznesit	A do të ndikojë në qasjen në financa për biznes?		X			
	A do të largohen nga tregu produkte të caktuara?		X			
	A do të lejohen në treg produkte të caktuara?		X			
	A do të detyrohen bizneset të mbyllen?		X			
	A do të krijohen biznese të reja?		X			
Ngarkesa administrative	A do të detyrohen bizneset t'i përmbushin detyrimet e dhënies së informatave të reja?		X			

<sup>35</sup> Kur ndikon në vendet e punës, gjithashtu do të ketë edhe ndikime shoqërore.



	A janë thjeshtuar detyrimet e dhënies së informatave për bizneset?		X			
Tregtia	A pritet të ndryshojnë flukset aktuale të importit?		X			
	A pritet të ndryshojnë flukset aktuale të eksportit?		X			
Transporti	A do të ketë efekt në mënyrën e transportit të pasagjerëve dhe/ose mallrave?		X			
	A do të ketë ndonjë ndryshim në kohën e nevojshme për të transportuar pasagjerë dhe/ose mallra?		X			
Investimet	A pritet që kompanitë të investojnë në veprimtari të reja?		X			
	A pritet që kompanitë t'i anulojnë ose shtyjnë për më vonë investimet?		X			
	A do të rriten investimet nga diaspora?		X			
	A do të zvogëlohen investimet nga diaspora?		X			
	A do të rriten investimet e huaja direkte?		x			
	A do të zvogëlohen investimet e huaja direkte?		x			
Konkurrueshmëria	A do të rritet çmimi i biznesit të produkteve, siç është energjia elektrike?		x			

	A do të ulet çmimi i inputeve të bizneseve, siç është energjia elektrike?		x			
	A ka gjasa që të promovohen inovacioni dhe hulumtimi?		x			
	A ka gjasa që inovacioni dhe hulumtimi të pengohen?		x			
Ndikimi në NVM	A janë kompanitë e prekura kryesisht NVM?		x			
Çmimet dhe konkurrenca	A do të rritet numri i mallrave dhe shërbimeve në dispozicion për biznesin apo konsumatorët?		x			
	A do të zvogëlohet numri i mallrave dhe shërbimeve në dispozicion për biznesin apo konsumatorët?		x			
	A do të rriten çmimet e mallrave dhe shërbimeve ekzistuese?		x			
	A do të ulen çmimet e mallrave dhe shërbimeve ekzistuese?		x			
Ndikimet ekonomike rajonale	A do të ndikohet ndonjë sektor i veçantë i biznesit?		x			
	A është ky sektor i koncentruar në një rajon të caktuar?		x			
Zhvillimi i përgjithshëm ekonomik	A do të ndikohet rritja e ardhshme ekonomike?		x			
	A mund të ketë ndonjë efekt në normën e inflacionit?		x			

Shtojca 2: Forma e vlerësimit për ndikimet shoqërore

Kategoria e ndikimeve shoqërore	Ndikimi kryesor	A pritët të ndodhë ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur	Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit	Niveli i preferuar i analizës
		Po	Jo			
Vendet e punës <sup>36</sup>	A do të rritet numri aktual i vendeve të punës?		x			
	A do të zvogëlohet numri aktual i vendeve të punës?		x			
	A ndikohen vendet e punës në një sektor të caktuar të biznesit?		x			
	A do të ketë ndonjë ndikim në nivelin e pagesës?		x			
	A do të ketë ndikim në lehtësimin e gjetjes së një vendi të punës?		x			
Ndikimet shoqërore rajonale	A janë ndikimet shoqërore të përqendruara në një rajon apo qytete të veçanta?		x			
Kushtet e punës	A ndikohen të drejtat e punëtorëve?		x			
	A parashihen apo shfuqizohen standardet për punën në kushte të rrezikshme?		x			
	A do të ketë ndikim mbi mënyrën e zhvillimit të dialogut social ndërmjet punonjësve dhe punëdhënësve?		x			
	A do të ketë ndikim mbi varfërinë?		x			

<sup>36</sup> Kur ndikon në vendet e punës, gjithashtu do të ketë edhe ndikime ekonomike.

Përfshirja sociale	A ndikohet qasja në skemat e mbrojtjes sociale?		x			
	A do të ndryshojë çmimi i mallrave dhe shërbimeve themelore?		x			
	A do të ketë ndikim në financimin apo organizimin e skemave të mbrojtjes sociale?		x			
Arsimi	A do të ketë ndikim në arsimin fillor?		x			
	A do të ketë ndikim në arsimin e mesëm?		x			
	A do të ketë ndikim në arsimin e lartë?		x			
	A do të ketë ndikim në aftësimin profesional?		x			
	A do të ketë ndikim në arsimimin e punëtorëve dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës?		x			
	A do të ketë ndikim në organizimin apo strukturën e sistemit arsimor?		x			
	A do të ketë ndikim në lirinë akademike dhe vetëqeverisjen?		x			
Kultura	A ndikon opsioni në diversitetin kulturor?		x			
	A ndikon opsioni në financimin e organizatave kulturore?		x			
	A ndikon opsioni në mundësitë për personat që të përfitojnë nga aktivitetet kulturore ose të marrin pjesë në to?		x			

	A ndikon opsioni në ruajtjen e trashëgimisë kulturore?		x			
Qeverisja	A ndikon opsioni në aftësitë e qytetarëve të marrin pjesë në procesin demokratik?		x			
	A trajtohet çdo person në mënyrë të barabartë?		x			
	A do të informohet më mirë publiku në lidhje me çështje të caktuara?		x			
	A ndikon opsioni në mënyrën se si funksionojnë partitë politike?		x			
	A do të ketë ndonjë ndikim në shoqërinë civile?		x			
Shëndeti dhe siguria publike <sup>37</sup>	A do të ketë ndonjë ndikim në jetën e njerëzve, siç është jetëgjatësia apo shkalla e vdekshmërisë?		x			
	A do të ketë ndikim në cilësinë e ushqimit?		x			
	A do të rritet apo zvogëlohet rreziku shëndetësor për shkak të substancave të dëmshme?		x			
	A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në nivelet e zhurmës apo cilësinë e ajrit, ujit dhe/ose tokës?		x			
	A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në përdorimin e energjisë?		x			

<sup>37</sup> Kur ka ndikim në shëndet publik dhe siguri, atëherë rregullisht ka ndikime mjedisore.

	A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në deponimin e mbeturinave?		x			
	A do të ketë ndikim në mënyrën e jetesës së njerëzve, siç janë nivelet e interesimit për sport, ndryshimet në ushqyeshmëri, ose ndryshimet në përdorimin e duhanit ose alkoolit?		x			
	A ka grupe të veçanta që përballen me rreziqe shumë më të larta se të tjerat (të përcaktuar sipas faktorëve, të tillë si mosha, gjinia, aftësia e kufizuar, grup shoqëror apo rajoni)?		x			
Krimi dhe siguria	A ndikohen gjasat që të kapen kriminelët?		x			
	A ndikohet fitimi i mundshëm nga krimi?		x			
	A ndikon në nivelet e korrupsionit?		x			
	A ndikohet kapaciteti i zbatimit të ligjit?		x			
	A ka ndonjë efekt në të drejtat dhe sigurinë e viktimave të krimit?		x			

Shtojca 3: Forma e vlerësimit për ndikimet mjedisore

Kategoria e ndikimeve mjedisore	Ndikimi kryesor	A pritët të ndodhë ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur I lartë/i ulët	Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit I lartë/i ulët	Niveli i preferuar i analizës
		Po	Jo			
Klima dhe mjedisi i qëndrueshëm	A do të ketë ndikim në emetimin e gazrave serë (dioksid karboni, metani etj.)?		x			
	A do të ndikohet konsumi i karburanteve?		x			
	A do të ndryshojë shumëllojshmëria e burimeve që përdoren për prodhimin e energjisë?		x			
	A do të ketë ndonjë ndryshim në çmim për produktet miqësore ndaj mjedisit?		x			
	A do të bëhen më pak ndotëse disa aktivitete të caktuara?		x			
Cilësia e ajrit	A do të ketë ndikim në emetimin e ndotësve të ajrit?		x			
Cilësia e ujit	A ndikon opsioni në cilësinë e ujërave të ëmbla?		x			
	A ndikon opsioni në cilësinë e ujërave nëntokësore?		x			
	A ndikon opsioni në burimet e ujit të pijshëm?		x			
Cilësia e tokës dhe	A do të ketë ndikim në cilësinë e tokës (në lidhje me acidifikimin,		x			

shfrytëzimi i tokës	ndotjen, përdorimin e pesticideve apo herbicideve)?					
	A do të ketë ndikim në erozionin e tokës?		x			
	A do të humbet tokë (përmes ndërtimit, etj.)?		x			
	A do të fitohet tokë (përmes dekontaminimit, etj.)?		x			
	A do të ketë ndonjë ndryshim në shfrytëzimin e tokës (p.sh. nga shfrytëzimi pyjor në shfrytëzim bujqësor apo urban)?		x			
Mbeturinat dhe riciklimi	A do të ndryshojë sasia e mbeturinave të krijuara?		x			
	A do të ndryshojnë mënyrat në të cilat trajtohen mbeturinat?		x			
	A do të ketë ndikim në mundësitë për riciklimin e mbeturinave?		x			
Përdorimi i burimeve	A ndikon opsioni në përdorimin e burimeve të ripërtëritshme (rezervave të peshkut, hidrocentraleve, energjisë diellore etj.)?		x			
	A ndikon opsioni në përdorimin e burimeve, të cilat nuk janë të ripërtëritshme (ujërat nëntokësore, mineralet, qymyri etj.)?		x			
Shkalla e rreziqeve mjedisore	A do të ketë ndonjë efekt në gjasat për rreziqe, të tilla, si zjarret, shpërthimet apo aksidentet?		x			



	A do të ndikojë në gatishmërinë në rast të fatkeqësive natyrore?		x			
	A ndikohet mbrojtja e shoqërisë nga fatkeqësitë natyrore?		x			
Biodiversiteti, flora dhe fauna	A do të ketë ndikim në speciet e mbrojtura apo të rrezikuara apo në zonat ku ato jetojnë?		x			
	A do të preket madhësia apo lidhjet midis zonave të natyrës?		x			
	A do të ketë ndonjë efekt në numrin e specieve në një zonë të caktuar?		x			
Mirëqenia e kafshëve	A do të ndikohet trajtimi i kafshëve?		x			
	A do të ndikohet shëndeti i kafshëve?		x			
	A do të ndikohet cilësia dhe siguria e ushqimit të kafshëve?		x			

Shtojca 4: Forma e vlerësimit për ndikimin e të drejtave themelore

Kategoria e ndikimit në të drejtat themelore	Ndikimi kryesor	A pritët të ndodhë ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur	Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit	Niveli i preferuar i analizës
		Po	Jo	I lartë/i ulët	I lartë/i ulët	
Dinjiteti	A ndikon opsioni në dinjitetin e njerëzve, në të drejtën e tyre për jetë apo në integritetin e një personi?		x			
Liria	A ndikon opsioni në të drejtën e lirisë së individëve?		x			
	A ndikon opsioni në të drejtën e një personi për privatësi?		x			
	A ndikon opsioni në të drejtën për t'u martuar apo krijuar familje?		x			
	A ndikon opsioni në mbrojtjen ligjore, ekonomike ose shoqërore të individëve apo familjes?		x			
	A ndikon opsioni në lirinë e mendimit, ndërgjegjes apo fesë?		x			
	A ndikon opsioni në lirinë e shprehjes?		x			
	A ndikon opsioni në lirinë e tubimit ose asociimit?		x			
Të dhënat personale	A përfshin opsioni përpunimin e të dhënave personale?		x			
	A janë të drejtat e individit për qasje, korrigjim dhe kundërshtim të garantuara?		x			

	A është e qartë dhe e mbrojtur mirë mënyra në të cilën përpunohen të dhënat personale?		x	U	L	
Azili	A ndikon ky opsioni në të drejtën për azil?		x			
Të drejtat pronësore	A do të ndikohen të drejtat e pronësisë?		x			
	A ndikon opsioni në lirinë për të bërë biznes?		x			
Trajtimi i barabartë <sup>38</sup>	A e mbron opsioni parimin e barazisë para ligjit?		x			
	A ka gjasa që grupe të caktuara do të dëmtohen në mënyrë direkte apo indirekte nga diskriminimi (p.sh. ndonjë diskriminim në bazë gjinore, racore, ngjyre, etnie, opinionimi politik ose tjetër, moshe ose orientimi seksual)?		x			
	A ndikon opsioni në të drejtat e personave me aftësi të kufizuara?		x			
Të drejtat e fëmijëve	A ndikon opsioni në të drejtat e fëmijëve?		x			
Administrimi i mirë	A do të bëhen procedurat administrative më të komplikuarat?		x			
	A ndikohet mënyra në të cilën administrata merr vendime (transparenca, afati procedural, e drejta për qasje në një dosje, etj.)?		x			

<sup>38</sup> Barazia gjinore trajtohet në *Vlerësimin e Ndikimit Gjinor*.

	Për të drejtën penale dhe ndëshkimet e parashikuara: a ndikohen të drejtat e të paditurit?		x			
	A ndikohet qasja në drejtësi?		x	U	L	L

